

MIRATOI

KRYETAR

Armando SUBASHI



NË MUNGESË DHE ME URDHËR

NËNKRYETAR

Mirela PITUSHI



PLANI ARSIMIT PARAUNIVERSITAR BASHKIA FIER

2026 – 2030

Arsim cilësor për të ardhmen



INVESTIM NË DIJE
INVESTIM NË TË ARDHMEN



Përmbajtja

| | |
|--|-------|
| 1. Hyrje dhe konteksti | 7 |
| Konteksti administrativ | 8 |
| Të dhëna demografike | 9-12 |
| Kudri ligjor dhe politika që përcakton bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit në nivel vendor | 12 |
| 2. Analiza e shërbimit të arsimit parashkollor në vitin shkollor 2025 – 2026 | 13 |
| Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit parashkollor | 14 |
| Kapaciteti dhe organizimi i grupeve..... | 15 |
| Regjistrimi i fëmijëve dhe përfshirja gjinore..... | 16 |
| Përfshirja e grupeve në nevojë..... | 16 |
| Shërbimi me ushqim..... | 16 |
| Burimet njerëzore dhe kualifikimet profesionale | 17 |
| 3. Analiza e shërbimit në shkolla bazë dhe atij të mesëm në vitin shkollor 2025 – 2026 | 18 |
| Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit | 19 |
| Frekuentimi në arsimin fillor | 19 |
| Frekuentimi arsimit 9-vjeçar | 20 |
| Frekuentimi arsimit të mesëm | 20 |
| 4. Analiza edhe shpërndarja e stafit arsimor në territorin e bashkisë | 21 |
| 5. Analiza 12 mujore e punës në Qendren e Fëmijëve me Aftësi Ndryshe “Horizont” për vitin 2025..... | 23 |
| 6. Shërbimi i Arsimit sipas Njësi Administrative..... | 24 |
| Njësia Administrative: Fier | 25 |
| Njësia Administrative: Cakran | 26 |
| Njësia Administrative: Mbrostar Ura | 28 |
| Njësia Administrative: Libofshë | 30 |
| Njësia Administrative: Qendër | 31 |
| Njësia Administrative: Dërmenas..... | 32 |
| Njësia Administrative: Levan..... | 33 |
| Njësia Administrative: Frakull | 35 |
| Njësia Administrative: Topojë..... | 36 |
| Njësia Administrative: Portëz..... | 37 |
| 7. Vizioni, qëllimet strategjike, objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar..... | 39 |
| Përmbledhje e Qëllimeve, Objektivave dhe Aktiviteteve..... | 40-42 |
| Përmbledhje e investimeve kapitale (2026–2028)..... | 47 |

| | |
|--|----|
| 8. Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar | 48 |
| 9. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve) | 49 |
| 10. Plani i investimeve kapitale | 55 |
| 11. Monitorimi dhe vlerësimi | 69 |
| 12. Rishikimi dhe përshtatja e planit | 71 |
| 13. Raportimi dhe transparenca | 72 |
| Aneks 1: Kuadri Ligjor dhe nënligjor për Arsimin Parauniversitar | 73 |

ARSIMI

Arsimi është një nga prioritetet strategjike të bashkisë Fier që planifikon, projekton dhe mbështet të gjitha përpjekjet për të arritur cilësinë në procesin e shërbimit arsimor. Vizioni ynë është të ndërtojmë një sistem arsimor që ofron mundësi të barabarta për çdo fëmijë, duke e mbështetur atë jo vetëm në aspektin infrastrukturor, por edhe në politikat e përfshirjes sociale, aksesit dhe mirëqenies së nxënësve. Në përputhje me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, bashkitë kanë kompetenca të rëndësishme në ofrimin e shërbimeve mbështetëse për institucionet arsimore. Korniza ligjore e decentralizimit, ku i referohemi VKM. nr. 691, datë 29.7.2015 “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015–2020”, nxit një bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet pushtetit vendor dhe institucioneve arsimore për të garantuar shërbime efikase dhe të qëndrueshme.

Plani i Arsimit Parauniversitar dhe hartimi i politikave zhvilluese e strategjike që priten të ndiqen dhe të zbatohen janë në përputhje me prioritetet kryesore të Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2021-2026 dhe rekomandimet e qeverisë shqiptare për agjendën e integritit në BE. Ai mbështetet mbi një proces gjithëpërfshirës dhe dhe ndërveprues ku janë angazhuar specialistë të fushës, institucione vendore, përfaqësues të shkollave, komunitetit dhe aktorë të tjerë.

Procesi i planifikimit ka kaluar në disa faza:

- Ngritja e grupit të punës dhe zhvillimi i konsultimeve paraprake;
- Mbledhja dhe analizimi i të dhënave për të identifikuar nevojat dhe sfidat;
- Hartimi i draftit paraprak të dokumentit;
- Konsultimi publik dhe miratimi përfundimtar në Këshillin Bashkiak.

Ky dokument synon të shërbejë si një udhërrëfyes për vendimmarrjen, me qëllim që arsimi në bashkinë Fier të jetë më cilësor, gjithëpërfshirës dhe i orientuar drejt nevojave reale të komunitetit dhe standardeve bashkëkohore evropiane.

Parathënie

Arsimi është drita që ndriçon rrugën e së ardhmes dhe themeli mbi të cilin ndërtohen brezat e rinj. Ai nuk është vetëm një proces i thjeshtë i përvetësimit të njohurive, por një udhëtim i gjatë formimi, që ndikon në mënyrën se si mendojmë, si veprojmë dhe si e ndërtojmë jetën tonë.

Çdo investim në arsim është një investim i drejtpërdrejtë në zhvillimin e shoqërisë. Për këtë arsye, arsimi ka qenë dhe do të mbetet gjithmonë në qendër të vëmendjes së Bashkisë Fier, si dhe të institucioneve të tjera dhe të gjithë shoqërisë.

Në kohën që jetojmë, sfidat janë gjithnjë e më komplekse. Teknologjia po ndryshon mënyrën e të mësuarit dhe të punuarit, duke kërkuar nga brezat e rinj jo vetëm njohuri, por edhe aftësi për t'u përshtatur, për të menduar në mënyrë kritike dhe për të qenë kreativë.

Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar 2026–2030 përfaqëson një vizion për të ardhmen e arsimit – një arsim inovativ, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt zhvillimit të plotë të individit. Në qendër të këtij vizioni qëndron fëmija, ndërsa përreth tij ndërtohet një rrjet i fortë mbështetës, i përbërë nga shkolla, familja, komuniteti dhe institucionet publike.


Nëse duam një të ardhme më të mirë, duhet të ndërtojmë sot një arsim më të fortë. Brezat e ardhshëm janë ata që do të udhëheqin shoqërinë, prandaj për Bashkinë Fier investimi në arsim nuk është thjesht një detyrë, por një mision për të ndërtuar një shoqëri më të drejtë, më të zhvilluar dhe më njerëzore.

Për realizimin e këtij vizioni, Bashkia Fier ka ndërmarrë një angazhim të vazhdueshëm që prej vitit 2015, duke filluar me rehabilitimin e godinave arsimore dhe duke vijuar në vitin 2026 me forcimin e mëtejshëm të infrastrukturës dhe cilësisë së shërbimeve arsimore. Deri në vitin 2030, synohet garantimi i një sistemi arsimor të barabartë, gjithëpërfshirës dhe cilësor për çdo fëmijë dhe të ri në territorin e Bashkisë Fier.

Fieri ka ditur gjithmonë ta vlerësojë arsimin. Këtë e tregojnë më së miri brezat e të rinjve që kanë mbushur auditorët e universiteteve, duke ndjekur ëndrrat e tyre dhe duke dëshmuar se investimi në dije është investimi më i sigurt për të ardhmen.

Ky synim do të realizohet përmes zgjerimit të aksesit në arsim, fuqizimit të institucioneve edukative si qendra komunitare, rritjes së kapaciteteve profesionale dhe ofrimit të mbështetjes së diferencuar për grupet në nevojë, me qëllim ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe të zhvilluar.

**KRYETARI I BASHKISË FIER
Z.ARMANDO SUBASHI**



Falënderime

Bashkia Fier shpreh falenderime dhe mirënjohje të veçantë për të gjithë ata që dhanë kontributin e tyre për përfundimin me sukses të procesit për hartimin e Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar 2026-2030. Ky proces është realizuar me mbështetjen e Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë dhe me ekspertizën teknike të “Smart Processes”, të cilët lehtësuan analizën, planifikimin dhe ndërtimin metodologjik të këtij dokumenti strategjik vendor.

Falënderojmë dhe shprehim mirënjohjen tonë të sinqertë për angazhimin e Këshillit Bashkiak të Fierit, për mbështetjen e dhënë gjatë gjithë procesit, si dhe për angazhimin e strukturave të tij në sigurimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe transparente në hartimin dhe miratimin e këtij plani .

Vlerësojmë pafund kontributin e drejtuesve të bashkisë, përfaqësuesve të drejtorive dhe sektorëve vendorë të arsimit, financave, infrastrukturës, shërbimeve sociale.

Mirënjohje për përkushtimin e të gjithë drejtuesve të institucioneve arsimore, edukatorëve dhe mësuesve që gjatë dëgjësave publike , si dhe bashkëpunimin e rëndësishëm me ndërmarjret në varësi të Bashkisë Fier ,Ndërmarrja e Shërbimeve dhe ,Ndërmarrja e Pastrim –Gjelbërimit , të cilë ofruan informacion të vlefshëm mbi nevojat reale në terren.

Mirënjohje shkon edhe për organizatat e shoqërisë civile, këshillat e prindërve, grupet komunitare dhe partnerët lokalë, grupe të tjera intersi të cilët morën pjesë në takime konsultative,në dëgjesa publike dhe ndihmuan në pasqyrimin e realitetit arsimor dhe prioritetëve të komunitetit.

1. Hyrje dhe konteksti

Bashkia Fier, e pozicionuar në pjesën jugperëndimore të vendit, në ultësirën perëndimore, shtrihet në zemër të fushës së Myzeqesë – një nga zonat më të gjera dhe më pjellore të Shqipërisë. Falë vendndodhjes së saj strategjike, ajo përbën një nyje të rëndësishme lidhëse ndërmjet veriut dhe jugut të vendit, si dhe një pikë kyçe që lidh hinterlandin me bregdetin e Adriatikut, duke pasur akses të afërt me plazhet e Semanit dhe Darëzezës. Në afërsi të territorit të saj rrjedhin dy nga lumenjtë kryesorë të Shqipërisë, Semani dhe Vjosa, të cilët pasurojnë më tej potencialin natyror të zonës. Fieri përfaqëson një qendër të rëndësishme urbane, ekonomike dhe administrative, me një popullsi të konsiderueshme dhe një rol të spikatur në zhvillimin rajonal. Ekonomia e bashkisë mbështetet në sektorë kyç, si industria – veçanërisht ajo e naftës dhe përpunimit – si dhe bujqësia, e favorizuar nga tokat pjellore të Myzeqesë. I njohur ndryshe si “kryeqyteti i Myzeqesë”, Fieri mbart një trashëgimi të pasur historike dhe kulturore, duke qenë në afërsi të dy prej qyteteve më të rëndësishme antike të rajonit, Apollonisë dhe Bylisit. Në vitet e fundit, Bashkia Fier ka njohur zhvillime të dukshme në infrastrukturë dhe në përmirësimin e shërbimeve publike. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar sektorit të arsimit, i cili mbetet një prioritet i qëndrueshëm i bashkisë. Investimet e vazhdueshme në çerdhe, kopshte dhe shkolla kanë synuar përmirësimin e kushteve dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve arsimore për komunitetin. Me një sipërfaqe prej 66,150 ha, Bashkia Fier përbëhet nga 10 njësi administrative: Fier, Cakran, Dermenas, Frakull, Levan, Libofshë, Mbrostar, Portëz, Qendër dhe Topojë. Bashkia e re e Fierit ka një popullsi prej 209,714 banorësh në total si bashki. Bazuar në Ligjin Nr. 115/2014 "Për ndarjen administrative – territoriale njësi të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Fieri mbetet qendra e Qarkut të Fierit, ndërsa qarku vetë ka në përbërje të tij bashkitë e reja të Mallakastrës, Patosit, Fierit, Lushnjes, Roskovecit dhe Divjakës. Territori i bashkisë karakterizohet nga një reliev kryesisht fushor, me një lartësi mesatare rreth 20 metra mbi nivelin e detit. Bashkia Fier kufizohet me bashkitë Divjakë, Lushnjë, Roskovec, Patos, Mallakastër, Selenicë dhe Vlorë.

Figura 1. Ndarja administrative e Bashkisë Fier



Bashkia e Fierit gëzon një pozicion strategjik në territorin shqiptar i mundësuar nga disa avantazhe ndërsektoriale.

Konteksti administrativ

Bashkia Fier përfshin një numër njësish administrative, secila prej të cilave luan një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve publike për komunitetin lokal, përfshirë edhe shërbimet e arsimit parashkollor.

Kjo strukturë e përbërë nga 10 njësi administrative përbëhet nga një ndërthurje e zonave urbane dhe rurale, çka ndikon ndjeshëm në mënyrën e organizimit të shërbimeve publike, si dhe në shpërndarjen e burimeve njerëzore, infrastrukturore dhe financiare.

Prania e diversitetit gjeografik dhe demografik mes njësive administrative kërkon një qasje të diferencuar në planifikimin dhe ofrimin e arsimit parashkollor, për të garantuar akses të barabartë dhe cilësi të njëtrajshme të shërbimit në të gjithë territorin e Bashkisë.

Aktualisht, Bashkia Fier përfshin gjithsej 10 njësi administrative:

- Fier
- Cakran
- Mbrostar Ura
- Libofshë
- Qendër
- Dërmenas
- Topojë
- Levan
- Frakull
- Portëz


të cilat përbëjnë bazën e ofrimit të shërbimeve publike, përfshirë arsimin parauniversitar, kopshtet dhe shkollat publike.

| Të dhëna administrative | Vlerë |
|-------------------------|---|
| Sipërfaqja | 661.5 km ² |
| Popullsia bashkisë | 101.963 banorë (Cens 2023) |
| Njësi administrative | 10 1- Qyteti (4 rajone) – 9 NJA, ish komuna: Levan, Frakull, Cakran, Portëz, Dërmëndas, Qerndër, Mbrostar, Libofshë, Topojë |
| Fshatra të përfshira | 85 fshatra |

Të dhëna demografike

Sipas të dhënave më të fundit demografike, numri total i banorëve në Bashkinë Fier është 101,963 banorë, me një shpërndarje të përafërt gjinore prej 51 074 meshkuj dhe 50 889 femra. Struktura e popullsisë karakterizohet nga një përqindje e konsiderueshme e fëmijëve në moshë parashkollore dhe të rinjve, gjë që nënvizon rëndësinë e zhvillimit dhe forcimit të shërbimeve arsimore në këto kategori.

Numri i banorëve sipas gjinisë



| Grup-mosha | Popullsia |
|------------|-----------|
| 0-4 vjeç | 4 076 |
| 5-9 vjeç | 5 087 |
| 10-14 vjeç | 5 842 |
| 15-19 vjeç | 5 250 |

Grupmosha 0–14 vjeç përfshin rreth 15,005 fëmijë, që përfaqësojnë mbi 14,7% të popullsisë. Ky kontingjent përbën bazën e sistemit arsimor parashkollor dhe parauniversitar dhe përbën një indikator të rëndësishëm për planifikimin e shërbimeve arsimore, sociale dhe shëndetësore për fëmijët. Brenda këtij segmenti, numri i fëmijëve 0–4 vjeç është 4 076, që do të thotë se nevoja për shërbime të edukimit të hershëm mbetet e lartë dhe kërkon vëmendje të veçantë në politikat lokale.


Grupmoshat 15–34 vjeç përbëjnë rreth 19,8% të popullsisë. Këto përfshijnë të rinjtë dhe të rriturit e rinj që janë potencial për arsimin terciar, formimin profesional dhe përfshirjen në tregun e punës. Kjo pjesë e popullsisë gjithashtu përfaqëson një pjesë të madhe të prindërve të fëmijëve të moshës shkollore, duke e bërë të rëndësishëm angazhimin e tyre në strukturat arsimore, komunitare dhe të politikave familjare.

Segmenti i popullsisë nga 35 deri në 59 vjeç është më i përfaqësuar dhe përbën rreth 32,3% të të gjithë banorëve. Kjo është grupmosha më aktive në aspektin ekonomik dhe social, me rol të drejtpërdrejtë në zhvillimin e komunitetit, rritjen dhe edukimin e fëmijëve dhe mbështetjen e gjeneratës së tretë. Politikat për zhvillim profesional, lehtësime për balancën punë-familje dhe mbështetje në edukimin e brezit të ri duhet të fokusohen në këtë segment.

Për sa i përket të moshuarve, popullsia mbi 60 vjeç përfaqëson rreth 33% të popullsisë së përgjithshme. Vetëm grupmosha 60–64 vjeç përbën 9.1% të popullsisë, ndërsa pjesa tjetër shpërndahet në mënyrë të qëndrueshme në moshat më të larta. Diferenca gjinore bëhet dukshëm më e madhe në këtë kategori: femrat janë ndjeshëm më të shumta, në moshat 70 vjeç e lart.

Profili demografik i Bashkisë Fier tregon për një strukturë popullore me një bazë rinore të qëndrueshme, një grup të fortë aktiv në moshë pune dhe një përqindje të konsiderueshme të të moshuarve. Kjo strukturë kërkon një balancim të kujdesshëm në planifikimin e politikave publike, duke adresuar njëkohësisht nevojat e fëmijëve për edukim dhe përkujdesje, të të rriturve për punësim dhe mbështetje sociale, si dhe të të moshuarve për shërbime shëndetësore dhe jetesë dinjitoze.

Piramida e Moshës – Census 2023 (Bashkia Fier)



| Grup-mosha | | Popullsia banuese Census 2023 |
|-----------------|----------|-------------------------------|
| Gjithsej | Gjithsej | 101 963 |
| | Meshkuj | 51 074 |
| | Femra | 50 889 |
| 0-4 | Gjithsej | 4 076 |
| | Meshkuj | 2 192 |
| | Femra | 1 884 |
| 5-9 | Gjithsej | 5 087 |
| | Meshkuj | 2 660 |
| | Femra | 2 427 |
| 10-14 | Gjithsej | 5 842 |
| | Meshkuj | 3 050 |
| | Femra | 2 792 |
| 15-19 | Gjithsej | 5 250 |
| | Meshkuj | 2 779 |
| | Femra | 2 471 |
| 20-24 | Gjithsej | 4 110 |
| | Meshkuj | 2 146 |
| | Femra | 1 964 |
| 25-29 | Gjithsej | 4 842 |
| | Meshkuj | 2 591 |
| | Femra | 2 251 |
| 30-34 | Gjithsej | 5 955 |
| | Meshkuj | 3 140 |

| | | |
|--------------|----------|-------|
| | Femra | 2 815 |
| 35-39 | Gjithsej | 6 030 |
| | Meshkuj | 3 088 |
| | Femra | 2 942 |
| 40-44 | Gjithsej | 5 607 |
| | Meshkuj | 2 794 |
| | Femra | 2 813 |
| 45-49 | Gjithsej | 5 976 |
| | Meshkuj | 2 815 |
| | Femra | 3 161 |
| 50-54 | Gjithsej | 7 178 |
| | Meshkuj | 3 459 |
| | Femra | 3 719 |
| 55-59 | Gjithsej | 8 166 |
| | Meshkuj | 3 948 |
| | Femra | 4 218 |
| 60-64 | Gjithsej | 9 321 |
| | Meshkuj | 4 560 |
| | Femra | 4 761 |
| 65-69 | Gjithsej | 8 580 |
| | Meshkuj | 4 203 |
| | Femra | 4 377 |
| 70-74 | Gjithsej | 6 634 |
| | Meshkuj | 3 262 |
| | Femra | 3 372 |
| 75-79 | Gjithsej | 4 354 |
| | Meshkuj | 2 127 |
| | Femra | 2 227 |
| 80-84 | Gjithsej | 3 194 |
| | Meshkuj | 1 486 |
| | Femra | 1 708 |
| 85 + | Gjithsej | 1 761 |
| | Meshkuj | 774 |
| | Femra | 987 |

Popullsia banuese më 1 Janar 2025 sipas grupmoshës dhe gjinisë

Qarku Fier

| Grup-mosha | Meshkuj | Femra | Gjithsej |
|-----------------|----------------|----------------|----------------|
| 0-4 | 4,474 | 4,110 | 8,584 |
| 5-9 | 5,445 | 4,919 | 10,364 |
| 10-14 | 6,655 | 6,040 | 12,695 |
| 15-19 | 6,709 | 6,005 | 12,714 |
| 20-24 | 4,418 | 3,820 | 8,238 |
| 25-29 | 4,937 | 4,300 | 9,237 |
| 30-34 | 6,408 | 5,663 | 12,071 |
| 35-39 | 7,018 | 6,275 | 13,293 |
| 40-44 | 6,376 | 6,548 | 12,924 |
| 45-49 | 6,537 | 7,310 | 13,847 |
| 50-54 | 7,541 | 8,696 | 16,237 |
| 55-59 | 9,713 | 10,554 | 20,267 |
| 60-64 | 11,080 | 11,592 | 22,672 |
| 65-69 | 10,547 | 10,677 | 21,224 |
| 70-74 | 7,707 | 7,659 | 15,366 |
| 75-79 | 5,505 | 5,595 | 11,100 |
| 80-84 | 3,709 | 3,907 | 7,616 |
| 85+ | 2,100 | 2,666 | 4,766 |
| Gjithsej | 116,879 | 116,336 | 233,215 |

Kuadri ligjor dhe politika që përcakton bazën referuese për detyrat dhe përgjegjësitë në fushën e arsimit në nivel vendor

Zbatimi i funksioneve të Bashkisë Fier në fushën e arsimit parauniversitar mbështetet në një kuadër të gjerë kushtetues, ligjor dhe politik, i cili përcakton të drejtat, detyrimet dhe kompetencat e institucioneve publike për garantimin e të drejtës për arsim. Baza më e lartë ligjore është **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, e cila në **nenin 57, pika 1, sanksionon të drejtën për arsim** për të gjithë qytetarët. Kjo e drejtë konkretizohet më tej përmes **Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”**, i ndryshuar me **Ligjin nr. 48/2018**, i cili përcakton strukturën dhe funksionimin e sistemit arsimor në të gjitha nivelet, duke përfshirë arsimin parashkollor, arsimin bazë, arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe atë profesional. Ky ligj rregullon gjithashtu standardet e cilësisë, përfshirjes, vlerësimit dhe menaxhimit të institucioneve arsimore.

Në nivel vendor, **Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”** u njeh bashkive kompetenca për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e çerdheve dhe kopshteve publike, si dhe role mbështetëse në arsimin bazë dhe të mesëm, përmes sigurimit të infrastrukturës, nxitjes së përfshirjes sociale dhe bashkëpunimit me institucionet qendrore. Këto funksione mbështeten financiarisht në përputhje me **Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”** dhe **Ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”**, të cilët përcaktojnë rregullat e menaxhimit financiar në nivel vendor. Gjithashtu, **Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”**, i ndryshuar, shërben si instrument për sigurimin e të ardhurave vendore që kontribuojnë në financimin e sektorit të arsimit.

Në aspektin e zbatimit, funksionimi i institucioneve arsimore rregullohet nga një sërë aktesh nënligjore. Ndër më të rëndësishmet janë: **Urdhri nr. 31, datë 28.01.2020**, që miraton rregulloren e përgjithshme për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare; **Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023**, që përcakton normat për numrin e nxënësve në klasë dhe ngarkesën mësimore të mësuesve; si dhe **udhëzim i përbashkët MAS–MEKI nr. 20, datë 13.08.2025**, “Për vitin shkollor 2025– 2026 në sistemin arsimor parauniversitar. Po ashtu, **Udhëzimi nr. 25, datë 25.07.2018**, rregullon ngritjen dhe funksionimin e bordeve të institucioneve arsimore, si mekanizma të rëndësishëm për pjesëmarrjen dhe monitorimin. Një dokument i rëndësishëm për sigurimin e cilësisë në arsimin parashkollor është **Urdhri nr. 199, datë 07.05.2024**, i cili miraton Kornizën e vlerësimit të cilësisë së kopshteve.

Në përputhje me parimet e gjithëpërfshirjes dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, Bashkia Fier udhëhiqet edhe nga **Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”** dhe **Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”**, të cilët kërkojnë ndërhyrje të koordinuara për mbështetjen e fëmijëve në nevojë dhe parandalimin e përjashtimit social. Në këtë kuadër, udhëzime specifike si **Udhëzimi nr. 21, datë 08.08.2014**, për rritjen e frekuentimit të arsimit nga fëmijët romë, si dhe **Plani Kombëtar i Veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025**, shërbejnë si udhërrëfytes për hartimin dhe zbatimin e politikave lokale.

Një tjetër komponent i rëndësishëm është ofrimi i shërbimit psiko-social në institucionet arsimore, i rregulluar përmes **Urdhrit nr. 313, datë 20.10.2020**, si dhe udhëzuesve përkatës për praktikën e punës së këtij shërbimi. Gjithashtu, për garantimin e një mjedisi të sigurt dixhital për fëmijët, zbatohet **Udhëzimi i përbashkët MAS-MShMS nr. 658, datë 23.09.2019**, i cili përcakton masa për mbrojtjen e tyre nga përmbajtjet e dëmshme në internet.


Nëpërmjet këtij kuadri të plotë ligjor dhe politik, Bashkia Fier ushtron një rol kyç në zbatimin e politikave arsimore dhe sociale në nivel vendor, duke synuar garantimin e një sistemi arsimor cilësor, gjithëpërfshirës dhe të aksesueshëm për të gjithë fëmijët. Në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën Vendore Arsimore dhe institucionet e tjera publike, synohet adresimi efektiv i nevojave të komunitetit dhe përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve arsimore.

1. Analiza e shërbimit të arsimit parashkollor në vitin shkollor 2025 – 2026

Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit parashkollor

Në Bashkinë Fier, shpërndarja e institucioneve arsimore sipas njësive administrative tregon një prani të konsiderueshme të infrastrukturës shkollore dhe të arsimit parashkollor në të gjithë territorin. Bazuar në të dhënat e paraqitura, në Bashkinë Fier funksionojnë 86 kopshte publike dhe jopublike të shpërndara në zonat urbane dhe rurale të territorit të saj. Shpërndarja gjeografike e kopshtit tregon një përpjekje për të garantuar akses të barabartë në edukimin parashkollor, si në qendrat urbane ashtu edhe në zonat më të thella rurale.

Kopshtet sipas njësive administrative



- Nj.A. Fier 19 kopshte publike+14 kopshte jopublike, gjithsej 33
- Nj. A Cakran 8 kopshte publike
- Nj.A. Mbrostar Ura 5 kopshte publike
- Nj.A. Libofshë 5 kopshte publike
- Nj. A. Qendër 5 kopshte publike
- Nj.A. Dërmenas 7 kopshte publike
- Nj.A. Topojë 4 kopshte publike
- Nj.A. Levan 6 kopshte publike
- Nj.A. Frakull 7 kopshte publike
- Nj.A. Portëz 6 kopshte publike


Gjithsej Bashkia Fier për vitin 2025 ka funksionalë 86 kopshte nga të cilat 72 publike dhe 14 jopublike. Në bashkinë Fier, në vitin shkollor 2025 në fund të vitit, aksesit i fëmijëve të grupmoshës 3-6 vjeç në arsimin parashkollor të cilët rezultojnë të rregjistruar dhe frekuentojnë në kopshtet publike në varësi të Qendrës Ekonomike të Arsimit janë **2,116 fëmijë**, konkretisht 1,167 djem dhe 949 vajza dhe 540 fëmijë ndjekin arsimin parashkollor jopublik konkretisht 286 djem dhe 254 vajza. Fëmijë të rregjistruar në 5 cerdhet e qytetit janë **319**. Në territorin e Bashkisë Fier ndodhet dhe funksionon shkolla "Horizont" për fëmijet me aftësi të kufizuara, ku shërbehet edhe ushqim për fëmijët.

-Arsimimi i personave me aftësi të kufizuara, një nga prioritetet kryesore është gjithpërfshirja dhe mbështetja e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në kopshtet e qytetit janë **26 fëmijë** me aftësi të kufizuara që u ofrohet shërbim mësimor. Qendra Ekonomike e Arsimit mbulon me ambiente dhe me shërbim duke ofruar një shërbim të barabartë dhe jo diskriminues për komunitetin **Rom** në kopshte **për 28 fëmijë të rregjistruar**. Në një përqindje të përgjithshme prej 79,67% të fëmijëve që janë të përfshirë në arsimin parashkollor publik dhe 20,33% të fëmijëve që janë të përfshirë në arsimin parashkollor jopublik.

| E dhëna | Njesia matese | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 |
|--|---------------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|
| Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor | numër | 2,454 | 2,234 | 2,250 | 2,099 | 2,124 | 2,116 |

| Kategoria | Djem | Vajza | Totali |
|------------------------------|--------------|--------------|--------------|
| Publik | 1,167 | 949 | 2,116 |
| Jopublik | 286 | 254 | 540 |
| Totali i përgjithshëm | 1,453 | 1,203 | 2,656 |

Grafiku më poshtë paraqet numrin e fëmijëve që ndjekin dhe nuk ndjekin kopshtet publike, sipas grupit total, djemve dhe vajzave.



Ky tregues, tregon prirje që mund të ndikohen nga faktorë lokalë si infrastruktura, ndërgjegjësimi prindëror apo mundësitë ekonomike. Këto të dhëna theksojnë rëndësinë e ndërhyrjeve të fokusuar në zgjerimin e aksesit, rritjen e ndërgjegjësimit komunitar dhe përmirësimin e infrastrukturës së arsimit parashkollor, me qëllim garantimin e të drejtës për arsim të barabartë dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët e moshës 3–6 vjeç në territorin e Bashkisë Fier.

Kapaciteti dhe organizimi i grupeve

Institucionet e arsimit parashkollor në Fier paraqiten me një kapacitet mesatar prej rreth 29–30 fëmijësh për institucion, me diferenca të ndjeshme që variojnë nga 10 në zona rurale deri në 190 fëmijë në kopsht me ushqim në zonat urbane. Kjo shpërndarje sugjeron se disa kopshte janë potencialisht të mbingarkuara, ndërsa të tjera nën- shfrytëzohen.

Regjistrimi i fëmijëve dhe përfshirja gjinore

Numri mesatar i fëmijëve të regjistruar për institucion është 30, duke arritur deri në 189 fëmijë në disa institucione, çka sugjeron përqendrim të lartë në zona të caktuara. Përfshirja gjinore është e balancuar duke reflektuar një përfshirje të drejtë mes gjinive. Megjithatë, disa institucione kanë numër më të ulët regjistrimesh, ç'ka sugjeron nevojën për ndërhyrje në informim komunitar dhe mbështetje logjistike për familjet që nuk i sjellin fëmijët në kopshte.

Përfshirja e grupeve në nevojë

Të dhënat tregojnë një përfshirje të fëmijëve romë dhe egjiptianë, Për fëmijët me aftësi ndryshe, rezulton që në shumicën e institucioneve ka 1–2 fëmijë me nevoja të veçanta. Është e nevojshme të forcohen lidhjet ndër-institucionale me strukturat e mbrojtjes së fëmijëve, njësitë sociale dhe OJF-të, për të garantuar që fëmijët nga grupe vulnerabël të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga arsimit parashkollor.

“Gjithëpërfshirja në arsim nënkupton krijimin e kushteve që të gjithë djemtë dhe vajzat, pavarësisht aftësive dhe karakteristikave të tjera, të vijnë në mësimet bashkë, duke u kujdesur për nevojat individuale të tyre. Gjithëpërfshirja synon rritjen e pjesëmarrjes në arsim në fëmijërinë e hershme, si dhe të pjesëmarrjes në arsim të fëmijëve nga grupet vulnerabël.”

Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026 ndërlidhet me Objektivin 4 të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm “Arsim parauniversitar cilësor dhe gjithëpërfshirës”.

Shërbimi me ushqim

9 kopshte ofrojnë shërbim me ushqim, ndërkohë që 63 kopshte funksionojnë pa ushqim. Kopshtet me ushqim janë të përqëndruara në qytet Rekomandohet që në kuadër të planeve buxhetore dhe investimeve të ardhshme, përfshirja e komponentit ushqimor të vazhdojë të shtohet edhe në njësi administrative aty ku vlerësohet edhe si një kërkesë e prindërve dhe familjeve. **Standarti** :Menu e përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS), Kopshtet duhet të ofrojnë ushqim në përputhje me Urdhrin nr. 76/1, datë 24.01.2018, si dhe Urdhrin nr. 457, datë 13.06.2018, i ndryshuar me Urdhrin nr. 76/1, “Për menutë ushqimore në çerdhe dhe kopshte për fëmijët 0–6 vjeç”.

Rekomandime:

- Ndërtim i një sistemi të dhënash digjitale për kopshtet dhe shkollat në kuadër të planit për përmirësim të arsimit parauniversitar,
 - Rishpërndarje e stafit aty ku ka tejkalim apo mungesë, Trajnim dhe kontraktim i profilit të punonjësve sipas nevojës, Sigurimi i stafit për shërbime mbështetëse në zonat rurale, Përmirësim i shërbimit me psikologë dhe punonjës socialë, Krijimi dhe monitorimi i një kalendari të detyrueshëm vjetor për trajnimin e stafit.
 - Zgjerimi i shërbimit të ushqimit në kopshte rurale, duke identifikuar 1-2 institucione pilot për nisjen e ofrimit të drekës.
 - Hartimi i një liste standarde të pajisjeve bazë për kuzhinën, e vlefshme për kopshte me potencial për ofrim ushqimi.
 - Përfshirja është e gjerë, por kërkon më shumë thellim për fëmijët në situatë rruge dhe ata me nevoja të veçanta, ku dallohen mungesa specifike në disa shkolla.
- Shkollat urbane mbartin ngarkesën më të lartë të grupeve vulnerabël, çka kërkon mbështetje më të madhe përmes psikologëve shkollorë, asistentëve socialë dhe infrastrukturës gjithëpërfshirëse. Përmirësimi i dokumentimit dhe raportimit të të dhënave është i nevojshëm për të shmangur mospërputhje në shifra (si në rastin e fëmijëve në rrugë që frekuentojnë më

shumë sesa janë identifikuar në total). ZVA duhet të rakordojë keto të dhëna me Drejtorinë e Shërbimit Social pranë Bashkisë Nevojitet zhvillimi i planeve lokale të përfshirjes, veçanërisht për shkollat rurale që nuk raportojnë asnjë kategori, gjë që mund të jetë tregues i mungesës së identifikimit dhe jo domosdoshmërisht i mungesës reale të këtyre fëmijëve. Të rritet numri i bursave të akorduara për fëmijët në pamundësi financiare për të ndjekur shkollën, nëpërmjet bashkërendimit të punës me Zyrën Vendore Arsimore dhe Drejtorinë e Shërbimit Social në Bashki. (Gjatë viteve 2024-2026 Bashkia Fier gjatë kësaj periudhe ka pasqyruar një angazhim të qëndrueshëm institucional në mbështetje familjeve në nevojë dhe fëmijëve të cilët duhet të përfitojnë bursë bazuar në VKM 666, të ndryshuar.

Burimet njerëzore dhe kualifikimet profesionale

Në total, në institucionet publike të arsimit parashkollor janë të punësuar personel edukativ 181 punonjës nga të cilët drejtues 14, mësues parashkollor 156, mësues ndihmës 8 dhe 3 psikologë, të cilët përfaqësojnë një komponent të rëndësishëm mbështetës në përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta ose për organizimin e grupeve të kombinuara në kopshte me ngarkesë të lartë.



Përsa i përket nivelit të kualifikimit profesional të mësuesve, të dhënat tregojnë një dominim të qartë të stafit me arsim të lartë, që arrin në 156 mësuese, duke reflektuar një standard të lartë formimi akademik në sistemin publik të parashkollorit .

Stafi edukativ ka përvojë pune si vijon: 0-5 vite pune janë 13 mësuese, 6-10 vite pune janë 28 mësuese, 11-15 vite pune janë 22 mësuese, 16-20 vite pune janë 31 mësuese, 21-25 vjet janë 33 mësuese dhe mbi 25 vite pune janë 37 mësuese.

Stafi edukativ janë me kualifikim si vijon: Për kategorinë III janë 31 mësuese, Për kategorinë II “Mësues specialist” janë 41 mësuese, Për kategorinë I “Mësues mjeshtër” janë 58 mësuese.

Stafi edukativ paraqet një përvojë të konsiderueshme profesionale, ku pjesa më e madhe e mësuesve kanë mbi 15 vite eksperiencë në punë. Konkretisht, 101 mësuese i përkasin kategorisë mbi 15 vite përvojë, çka tregon një trupë të konsoliduar dhe me eksperiencë në arsimin parashkollor.

Sa i përket kualifikimit profesional, vihet re një përqindje e lartë e mësuesve me kategori të avancuara, ku dominojnë mësueset me titullin “Mësues mjeshtër” dhe “Mësues specialist”. Kjo dëshmon për një nivel të mirë profesional dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies.



2. Analiza e shërbimit të në shkolla bazë dhe atij të mesëm në vitin shkollor 2025 – 2026

Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit

Shkollat në territorin e Bashkisë janë të organizuara dhe të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë sa më mirë nevojat arsimore të komunitetit. Ato klasifikohen në disa nivele sipas ciklit të edukimit që ofrojnë, duke përfshirë: shkolla vartëse (20 gjithsej), shkolla 9-vjeçare (32 gjithsej) dhe



shkolla të mesme (4 gjithsej) dhe part time, 6 të mesme të bashkuara dhe 1 shkollë e mesme e bashkuar me orientim(Shkolla e Muzikës).


❖ **Shkollat 9-vjeçare**, gjithsej 39 në numër nga të cilat 32 publike dhe 7 jopublike përfshijnë si ciklin fillor, ashtu edhe atë të mesëm të ulët, dhe janë projektuar për të ofruar një arsim të plotë bazë. Ato luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin akademik dhe shoqëror të nxënësve dhe përgatitjen e tyre për nivelin e ardhshëm arsimor.

❖ **Shkollat e mesme**, 11 në numër, nga të cilat 4 shkolla të mesme publike, 6 të mesme të bashkuara si dhe part time dhe 1 shkollë e mesme e bashkuar me orientim(Shkolla e Muzikës). Gjithashtu, në Bashkinë Fier janë 2 shkolla

profesionale.Këto janë institucione që synojnë të formojnë të rinjtë për studime të mëtejshme universitare apo për përgatitje për tregun e punës. Këto shkolla janë të vendosura në zona strategjike për të përfshirë një numër sa më të madh nxënësish nga zona të ndryshme të bashkisë. Gjithashtu Bashkia Fier ka dhe konvikt që i takojnë shkollave profesionale.Në tërësi, rrjeti arsimor i Bashkisë është konceptuar për të siguruar mundësi të barabarta arsimimi për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, pavarësisht vendbanimit apo kushteve ekonomike.

Shperndarja e Institucioneve arsimore në Bashkinë Fier

- Shkolla 9- vjeçare
- Shkollë të mesme
- Shkollë të mesme e bashkuar
- Shkollë të mesme e orientuar
- Shkolla jopublike
- Shkolla profesionale



Frekuentimi në arsimin fillor

| Gjinia | Numri i Nxënësve | Përqindja (%) |
|--|------------------|---------------|
| Djem | 2,236 | 53.62 |
| Vajza | 1,934 | 46.38 |
| Numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin fillor | 4,170 | |

Në arsimin fillor janë të regjistruar gjithsej 4,170, nga të cilët 2,236 janë djem dhe 1,934 vajza. Sipas të dhënave të raportuara, 53.62 % e tyre janë djem dhe 46.38 % vajza. Kjo ndarje reflekton situatën e përfshirjes në këtë nivel arsimor, e cila ndryshon nga njësi në njësi, në varësi të kushteve lokale, demografisë, dhe mundësive të ofruara në komunitet. Të dhënat nënvizojnë rëndësinë e vazhdimet të përpjekjeve për të garantuar akses të barabartë dhe gjithëpërfshirës në arsimin fillor për të gjithë

fëmijët, pavarësisht vendbanimit apo karakteristikave të tjera sociale. Sigurimi i kushteve të përshtatshme për ndjekjen e shkollës dhe mbështetja institucionale mbeten faktorë kyç për përmirësimin e mëtejshëm të përfshirjes.

Frekuentimi arsimit 9-vjeçar

Në arsimin 9-vjeçar janë të regjistruar gjithsej 3,915 nxënës, prej të cilëve 2,039 janë djem dhe 1,876 vajza. Sipas të dhënave, 52.08% e nxënësve janë djem dhe 47.92% janë vajza. Kjo shpërndarje pasqyron situatën aktuale të përfshirjes në këtë nivel arsimor, e cila ndryshon nga njësi në njësi dhe ndikohet nga faktorë të ndryshëm lokalë. Pavarësisht variacioneve, këto të dhëna nënvizojnë rëndësinë e monitorimit të rregullt të pjesëmarrjes së fëmijëve në arsim dhe nevojën për politika që mbështesin vazhdimësinë e shkollimit për të gjithë. Sigurimi i kushteve të favorshme për ndjekjen e arsimit 9-vjeçar është thelbësor për garantimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të barabartë për çdo fëmijë.

| Gjinia | Numri i Nxënësve | Përqindja (%) |
|--|------------------|---------------|
| Djem | 2,039 | 52.08 |
| Vajza | 1,876 | 47,92 |
| Numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin 9 vjeçar | 3,915 | |

Frekuentimi arsimit i mesëm

| Gjinia | Numri i Nxënësve | Përqindja (%) |
|---|------------------|---------------|
| Djem | 979 | 48,1 |
| Vajza | 1 056 | 51,9 |
| Numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin mesëm | 2 035 | |

Në arsimin e mesëm janë të regjistruar gjithsej 2 035 nxënës, nga të cilët 979 janë djem dhe 1,056 vajza, përkatësisht 48,1% djem dhe 51,9% vajza. Ndarja gjinore në këtë nivel arsimor pasqyron situatën e raportuar për njësinë përkatëse, por këto përqindje mund të jenë të ndryshme në zona të tjera. Shpërndarja e pjesëmarrjes në arsimin e mesëm ndikohet nga faktorë të shumtë si zgjedhjet individuale, mundësitë

për të ndjekur shkolla të përgjithshme apo profesionale, si dhe faktorë socialë, ekonomikë apo kulturorë. Kjo e bën të nevojshme që të mbështetet përfshirja e vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse në këtë nivel të rëndësishëm të arsimit.

3. Analiza edhe shpërndarja e stafit arsimor në territorin e bashkisë

Në njësitë administrative të Bashkisë Fier, shpërndarja e stafit arsimor dhe ndihmës në institucionet arsimore parauniversitare pasqyron struktura të ndryshme në varësi të përmasave të territorit, numrit të institucioneve dhe kërkesës komunitare.


Në total, në arsimin bazë dhe parashkollor janë angazhuar **159 mësues** në kopshte, të cilët sigurojnë procesin edukativ të fëmijëve në nivel parashkollor. Ndërsa **8 mësues ndihmës dhe 3 psikologe** janë të pranishëm në disa institucione specifike, për të mbështetur integrimin dhe zhvillimin individual të fëmijëve me nevoja të veçanta ose në grupe me ngarkesë të lartë. Nga ana tjetër **207 punonjës ndihmës**, përfshirë sanitare, roje, dhe punonjës shërbimi, garantojnë funksionimin e përditshëm të institucioneve dhe mbështesin sigurinë, higjienën dhe mirëqenien e fëmijëve.

Shpërndarja e këtyre burimeve njerëzore është e njëtrajtshme ndërmjet njësive administrative sipas nevojës, madhësisë së institucioneve si dhe llojit të shërbimit të kërkuar si vijon:



NUMRI FAKTIK I PUNONJESVE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

- Mesues AF
- Mesues AMU
- Mesues AML
- Kryemesues
- ZVDrejtor AF
- Drejtor AF
- ZVDrejtor AMU
- Drejtor AMU
- ZVDrejtor AML
- Drejtor AML
- Mesues Ndhime
- Psikologe
- Punonjes social
- Oficere sigurie
- K.K
- K.C
- Mesues Dispozicioni



Analiza 12 mujore e punes ne Qendren e Femijeve me Aftesi Ndryshe "Horizont" per vitin 2025

- Gjate vitit 2025 kane marre sherbim ne sistem me kohe te plote nga ora 08:00- 12:15 , **34 femije dhe te rinj** te moshes 6-19 vjec konkretisht : **mesim, terapi, integrim, laboratore**, etj. Femijet kane qene te ndare ne 4 klasa sipas deftesave.
Per moshen nga 6-19 vjec ka program mesimor specifik miratuar nga Ministria e Arsimit per femijet dhe te rinjte me A.K, ku punojne mesuese te arsimit special te cilat jane ne varesi te shkolles Liri Gero.. Femijet mbasi mbarojne klasat e arsimit special pajisen dhe me deftesat perkatese.
- Ka patur **24 (njezete e kater)** rregjistrime te reja gjate gjithë vitit 2025, dosjet kane kaluar ne komisionin e vleresimit dhe pranimit.
- Jane larguar **2(dy) femije** jashte shtetit.
- **11(njembedhjete)** femije mbaruan nevojat terapeutike me psikologun qe kishin nevojë.
- **1(nje)** femije jane shkeputur per arsye migrimi.
- **5(pese)** femije mbushen moshen e marrjes se sherbimit ne Qender.
- Jane ndjekur me terapi mbasdite **31 femije dhe te rinj**, te cilet **kane frekuentuar Qendren ne menyre te alternuar..**
- Nga keta **95** femije dhe te rinj gjithesej qe marrin sherbim ne Qender, **60** jane meshkuj dhe **35** jane femra.
- Ndiqen ne shkolla normale **37 femije** ne bashkepunim,punonjes social te qendres me psikologet e shkollave.
- Ndiqen ne kopshte **32 femije** ne bashkepunim,punonjes social te qendres me psikologet e kopshteve.
- Perverc aktiviteteteve me femijet dhe te rinjte rendesi iu eshte dhene dhe aktiviteteteve me prinderit e tyre, eshte punuar me **95 familje** dhe se bashku me psikologet dhe punonjesit social organizohen seanca keshillimi per nje pune paralele, specialist – mesues – familje.

4. Shërbimi i Arsimit sipas Njësie Administrative

Njësia Administrative: Fier

Shkollat

Në total në qytetin e Fier, funksionojnë 50 shkolla, nga të cilat 43 publike (+20 vartëse) dhe 7 jopublike, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Nga këto 39 janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit, nga të cilat 32 publike dhe 7 jopublike, si dhe 4 janë shkolla të mesme që u japin të rinjve mundësinë për të vijuar me arsimin e lartë nga të cilat 4 publike dhe 7 jopublike si dhe 2 shkolla të mesme profesionale, me qëllim për të hyrë në tregun e punës me përgatitje profesionale,

Gjithashtu në Bashkinë Fier ka dhe 1 konvikte i ndërtuar sipas standarteve bashkëkohore që i përkasin shkollave profesionale të dyja publike.

Përmes këtij sistemi, njësia siguron një shtrirje të gjerë të shërbimeve arsimore, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit dhe krijimin e kushteve për rritje të nivelit të arsimit dhe mirëqenies sociale. Këto institucione janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mundësojnë akses të qëndrueshëm në arsim për fëmijët e zonës, si në vendbanimet qendrore ashtu edhe në ato periferike apo rurale.

Lista e shkollave publike dhe private përfshin:

| Emri i Shkolles |
|--|
| Shkolla 9- vjeçare “Andon Xoxa”Fier |
| Shkolla 9- vjeçare “Kristaq Shtembari” Fier |
| Shkolla 9- vjeçare “Jani Bakalli” Fier |
| Shkolla 9- vjeçare “Liri Gero” Fier |
| Shkolla 9- vjeçare “Liri Gero Arsimi Special” Fier (vartëse) |
| Shkolla 9- vjeçare “Liri Gero AMU” me kohë të pjesëshme(vartëse) |
| Shkolla 9- vjeçare “Mark Dashi”Fier |
| Shkolla 9- vjeçare “Naim Frasheri”Fier |
| Shkolla 9- vjeçare “Pinellopi Pirro”Fier |
| Shkolla 9- vjeçare “Llazar Dashi” Sheq |
| Shkolla 9- vjeçare “Liko Kostandini”(vartëse) |
| Shkolla e mesme e bashkuar me orientim “Jakov Xoxa” Fier |
| Gjimnazi “Janaq Kilica”Fier |
| Gjimnazi “Perikli Ikonomi”Fier |
| Gjimnazi me kohë pjesëshme GJKP |
| Shkolla jopublike “Numani”Fier |
| Shkolla jopublike “Flatrat E Dijes”Fier |
| Shkolla jopublike “Mesonjetorja Dertli” Fier |

| |
|--|
| Shkolla jopublike “Alen” Fier |
| Shkolla jopublike “Bota E Diturisë” Fier |
| Shkolla jopublike “Shekulli I Ri” Fier |
| I.E.V.P FIER (vartëse Liri Gero” |
| Shkolla jopublike “Arkea 2000” Fier |

Kopshtet

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon një rrjet kopshtesh që synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje zhvillimore për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 33 kopshte nga të cilat publike 19 dhe jopublike 14, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit. Këto institucione luajnë një rol të rëndësishëm si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në mbështetjen sociale të familjeve. Gjithashtu vlen të theksohet se numrin më të madh të fëmijëve në kopshte e ka Njësia Administrative Fier pasi aty janë të përqëndruara dhe kopshtet me ushqim për të cilat ka më shumë kërkesa nga prindërit.

Lista e kopshteve publike dhe private përfshin:

| Emri i kopshtit |
|--|
| Kopshti Nr.1 (Me Ushqim) |
| Kopshti Nr. 2(Me Ushqim) |
| Kopshti Nr. 2 (Pa Ushqim) |
| Kopshti Nr. 3(Me Ushqim) |
| Kopshti Nr3(Pa Ushqim) |
| Kopshti Nr.4 (Me Ushqim) |
| Kopshti Nr. 5(Me Ushqim) |
| Kopshti Nr.6 (Me Ushqim) |
| Kopshti Nr.7 (Me Ushqim) |
| Kopshti Nr.8 (Me Ushqim) |
| Kopshti Nr.8 (Pa Ushqim) |
| Kopshti Nr. 9 (Me Ushqim) |
| Kopshti i shkollës 9-vjeçare (Mbrostar Ura-Kopshti Nr.9) |
| Kopshti Nr.10 (Me Ushqim) |
| Kopshti i shkollës 9- vjeçare “Andon Xoxa” (Kopshti 11) |
| Kopshti i shkollës 9- vjeçare “Liri Gero” (Kopshti 11) |
| Kopshti i shkollës 9- vjeçare "Jani Bakalli” (Kopshti 11) |
| Kopshti i shkollës 9- vjeçare “Jani Bocova”(Kopshti 11) |
| Kopshti i shkollës 9- vjeçare “Liko Kostandini”(Kopshti 11) |


| |
|---|
| Kopshti jo publik “Numani” |
| Kopshti jo publik “Dertliu” |
| Kopshti jo publik “Markelino” |
| Kopshti jo publik “Kesulekuqja” |
| Kopshti jo publik “Teletabis-Jon” |
| Kopshti jo publik “Amelia” |
| Kopshti jo publik “Bambi Ilma” |
| Kopshti jo publik “Ryend” |
| Kopshti jo publik “Luna” |
| Kopshti jo publik “Princeshë” |
| Kopshti jo publik “Sekreti Endrrave” |
| Kopshti jo publik “Marsel Gega P.F (Lulet E Pranverës)” |
| Kopshti jo publik “Canadian Kindergarten” |
| Kopshti jo publik “Alen” |

Njësia Administrative:

Cakran

Shkollat

Në total, funksionojnë 9 shkolla, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal. Gjashtë prej tyre janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit, 1 shkollë e mesme dhe 2 shkolla fillore.



Lista e shkollave përfshin:

| |
|--|
| Emri i Shkollës |
| Gjimnazi "Mustafa Hoxha",Cakran |
| Shkolla 9 - vjeçare "Qemal Mehmetaj" Cakran |
| Shkolla 9 - vjeçare "Feride Begaj" Gorishovë (vartëse sh.k Vreshtaz) |
| Shkolla 9 - vjeçare "Veiz Myslymi" Buzmadh |
| Shkolla 9 - vjeçare "Tefik Dautaj" Varibop |
| Shkolla Filllore CU Vjose(vartëse sh.k Varibop) |
| Shkolla Filllore CU Hambar (vartëse sh.k Varibop) |
| Shkolla 9 - vjeçare "Agur Merkaj" Vreshtaz |
| Shkolla 9 - vjeçare "Karafil Muskaj" Kreshpan |

Kopshtet

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon një rrjet kopshtesh që synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje zhvillimore për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 8 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

Lista e kopshteve përfshin:


| |
|---|
| Emri i kopshtit |
| Kopshti i shkollës 9 vjeçare " Feride Begaj " Gorishovë |
| Kopshti i shkollës 9 vjeçare "Qemal Mehmetaj,Cakran |
| Kopshti i shkollës 9 vjeçare "Veiz Myslymi,Buzmadh |
| Kopshti i shkollës 9 vjeçare "Tefik Dautaj",Varibop |
| Kopshti i shkollës fillore"Hambar" |
| Kopshti i shkollës fillore "Vjosë" |
| Kopshti i shkollës 9 vjeçare "Agur Merkaj"Vreshtaz |
| Kopshti i shkollës 9 vjeçare "Karafil Muskaj"Kreshpan |

Njësia Administrative:

Mbrostar Ura

Shkollat

Në total, funksionojnë 6 shkolla, 5 prej tyre janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit, dhe 1 shkollë e mesme e bashkuar. Këto institucione janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mundësojnë akses të qëndrueshëm në arsim për fëmijët e zonës, si në vendbanimet qendrore ashtu edhe në ato periferike apo rurale.



Lista e shkollave përfshin:

| Emri i Shkollës |
|---|
| Shkolla 9- vjeçare "Halit Grëmi" Mbrostar-Ura |
| Shkolla 9- vjeçare "Petro Baze" Petove(vartëse) |
| Shkolla e mesme e bashkuar "Vasil Sota" Vërri |
| Shkolla 9- vjeçare "Kristo Vide" Vajkan (vartëse) |
| Shkolla 9- vjeçare "Hiqmet Buzi" Kallm i madh |
| Shkolla 9- vjeçare "Europa" Kallm I Vogel |

Kopshtet

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative aktualisht janë të hapura gjithsej 6 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.


Lista e kopshteve përfshin:

| Emri i kopshtit |
|---|
| Kopshti i shkollës 9-vjeçare “Halit Gremi” Mbrostai Ura |
| Kopshti i shkollës 9-vjeçare “Hiqmet Buzi”,Kallm I Madh |
| Kopshti i shkollës 9-vjeçare “Petro Baze”, Petove |
| Kopshti i shkollës “Vasil Sota”,Verri |
| Kopshti i shkollës 9-vjeçare “Kristo Vide”,Vajkan |
| Kopshti i shkollës 9-vjeçare “Europa”,Kallm I Vogel |

Njësia Administrative: Libofshë

Shkollat

Në total, funksionojnë 3 shkolla. Nga këto, 2 janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit, dhe 1 shkollë e mesme e bashkuar.



Lista e shkollave përfshin:

| Emri i Shkollës |
|--|
| Shkolla e mesme e Bashkuar “Jovan Ndreko” Libofshë |
| Shkolla 9 - vjeçare “Kozma Ndreçka” Rreth Libofshe (vartëse) |
| Shkolla 9 - vjeçare “Thanas Laska” Ndërnënas |

Kopshtet

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon një rrjet kopshtesh që synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje zhvillimore për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 5 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

Lista e kopshteve përfshin:


| Emri i kopshtit |
|--|
| Kopshti i shkollës “Jovan Ndreko” libofshë |
| Kopshti Daullas |

| |
|---|
| Kopshti Agim,Libofshë |
| Kopshti shkollës 9 vjeçare Kozma Ndreçka,Rreth Libofshë |
| Kopshti shkollës 9 vjeçare Thanas Laska ,Ndernenas |

Njësia Administrative: Qendër

Shkollat

Në total, funksionojnë 4 shkolla, 3 prej tyre janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit, dhe 1 shkollë fillore.



Lista e shkollave përfshin:

| Emri i Shkolles |
|---|
| Shkolla 9 - vjeçare “Kostandin Peto” Clirim |
| Shkolla 9 - vjeçare “Thanas Ikonomi” Greçalli |
| Shkolla 9 - vjeçare “100 Vjetori I Pavarësisë” Zhupan |
| Shkolla Fillore CU Eleonora Bare Drizë (vartëse) |

Kopshtet

Në këtë njësi administrative, ofrimi i shërbimeve arsimore për fëmijët e moshës 3–6 vjeç mbështetet nga një rrjet kopshtesh që ka për qëllim të sigurojë edukim cilësor dhe zhvillim të gjithanshëm në fazën e hershme të fëmijërisë. Aktualisht janë në funksion **5 kopshte**, të cilat janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mundësojnë akses të barabartë për të gjitha familjet, si në zonat qendrore ashtu

edhe në ato periferike. Këto institucione nuk shërbejnë vetëm si hapësira për përgatitjen e fëmijëve për arsimin bazë, por edhe si pika kyçe të mbështetjes sociale për prindërit dhe komunitetin më gjerë.

Lista e kopshteve përfshin:

| Emri i kopshtit |
|---|
| Kopshti i shkollës 9-vjeçare “100 Vjetori I Pavarësisë”Zhupan |
| Kopshti Mujalli/Grecalli |
| Kopshti i shkollës 9-vjeçare “Konstandin Peto”,Çlirim |
| Kopshti i shkollës Drize Rom |
| Kopshti Daullas/Grecalli |


Njësia Administrative:

Dërmenas

Shkollat

Në territorin e kësaj njësie administrative funksionojnë gjithsej 6 shkolla, të organizuara në mënyrë të tillë që të plotësojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal në mënyrë të barabartë dhe të qëndrueshme. Ndër këto institucione,5 janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin e plotë bazë të arsimit, ndërsa 1 është shkolla e mesme e bashkuar.

Ky rrjet shkollash është shpërndarë në mënyrë të tillë që të garantojë akses në arsim për fëmijët dhe të rinjtë, pavarësisht vendbanimit të tyre, duke mbuluar si zonat urbane ashtu edhe ato periferike apo rurale. Përmes kësaj strukture arsimore të larmishme, njësia kontribuon në forcimin e kohezionit social, rritjen e nivelit të arsimit dhe përmirësimin e kushteve për zhvillim individual dhe komunitar.



Lista e shkollave përfshin:

| Emri i Shkolles |
|--|
| Shkolla 9 - vjeçare “Ymer Xhafa” Dermenas |
| Shkolla 9 - vjeçare “Miti Stroni” Pojan (vartëse) |
| Shkolla 9 - vjeçare “Baftjar Luzati” Radostinë |
| Shkolla e mesme e bashkuar “Levizja Demokratike” Povelçë |
| Shkolla 9 - vjeçare “Darezeze E Re”(vartëse) |
| Shkolla 9 - vjeçare “Trifon Prifti” Hamil |

Kopshtet

Aktualisht, në territorin e njësisë funksionojnë **7 kopshte**, të vendosura në zona të ndryshme me qëllim që çdo familje të ketë mundësi të barabarta për të përfituar nga këto shërbime. Përveç rolit të tyre edukativ, këto kopshte përbëjnë një mbështetje të rëndësishme sociale për prindërit dhe komunitetin, duke kontribuar në përgatitjen e fëmijëve për arsimin bazë dhe në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe nxitës për zhvillimin e tyre të hershëm.

Lista e kopshteve përfshin:

| Emri i kopshtit |
|--|
| Kopshti i shkollës 9- vjeçare “Miti Stroni”Pojan |
| Kopshti i shkollës 9- vjeçare “Baftjar Luzati”,Radostine |
| Kopshti i shkollës 9- vjeçare “Trifon Prifti”,Hamil |
| Kopshti Dërmenas |
| Kopshti Hoxharë E Vjetër |
| Kopshti Povelçë |
| Kopshti Darzezë |

Njësia Administrative: Levan

Shkollat

Në territorin e kësaj njësie administrative funksionojnë gjithsej 5 shkolla, të organizuara në mënyrë të tillë që të plotësojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal në mënyrë të barabartë dhe të qëndrueshme. Ndër këto institucione, 4 janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin bazë të arsimit, ndërsa 1 është shkolla të mesme e bashkuar që u ofrojnë të rinjve mundësinë për të vazhduar arsimin e lartë.

Ky rrjet shkollash është shpërndarë në mënyrë të tillë që të garantojë akses në arsim për fëmijët dhe të rinjtë, pavarësisht vendbanimit të tyre, duke mbuluar si zonat urbane ashtu edhe ato periferike apo rurale. Përmes kësaj strukture arsimore të larmishme, njësia kontribuon në forcimin e kohezionit social, rritjen e nivelit të arsimit dhe përmirësimin e kushteve për zhvillim individual dhe komunitar.

Lista e shkollave përfshin:

| Emri i Shkolles |
|---|
| Shkolla e mesme e bashkuar "Dino Ismaili" Levan |
| Shkolla 9- vjeçare "Thoma Sema" Ferras (vartëse) |
| Shkolla 9- vjeçare "Sotir Prifti" Shtyllas (vartëse) |
| Shkolla 9- vjeçare "Xhevit Fetahu", Bishan |
| Shkolla 9- vjeçare "Mehmet Salo Shahaj" Peshtan I Madh(vartëse) |


Kopshtet

Aktualisht, në territorin e njësisë funksionojnë **7 kopshte**, të vendosura në zona të ndryshme me qëllim që çdo familje të ketë mundësi të barabarta për të përfituar nga këto shërbime. Përveç rolit të tyre edukativ, këto kopshte përbëjnë një mbështetje të rëndësishme sociale për prindërit dhe komunitetin, duke kontribuar në përgatitjen e fëmijëve për arsimin bazë dhe në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe nxitës për zhvillimin e tyre të hershëm.

Lista e kopshteve përfshin:

| Emri i kopshtit |
|--|
| Kopshti Rom Levan |
| Kopshti Levan |
| Kopshti i shkollës 9- vjeçare "Xhevit Fetahu" Bishan |
| Kopshti Shtyllas |
| Kopshti Qarr |
| Kopshti Ferras |

Shkollat në Njësinë administrative Levan




Njësia Administrative:

Frakull

Shkollat

Në territorin e kësaj njësie administrative funksionojnë gjithsej 7 shkolla, të organizuara në mënyrë të tillë që të plotësojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal në mënyrë të barabartë dhe të qëndrueshme. Ndër këto institucione, 2 është shkollë fillore, 4 janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin e plotë bazë të arsimit, ndërsa 1 është shkolla e mesme e bashkuar që u ofrojnë të rinjve mundësinë për të vazhduar arsimin e lartë.

Ky rrjet shkollash është shpërndarë në mënyrë të tillë që të garantojë akses në arsim për fëmijët dhe të rinjtë, pavarësisht vendbanimit të tyre, duke mbuluar si zonat urbane ashtu edhe ato periferike apo rurale. Përmes kësaj strukture arsimore të larmishme, njësia kontribuon në forcimin e kohezionit social, rritjen e nivelit të arsimit dhe përmirësimin e kushteve për zhvillim individual dhe komunitar.



Lista e shkollave përfshin:

| Emri i Shkolles |
|--|
| Shkolla 9-vjeçare “Ramiz Ceka”Frakull e Madhe |
| Shkolla 9-vjeçare Frakull E Vogel (Vartëse Sheq Musalalaj) |
| Shkolla 9-vjeçare “Avdi Metaj”Peshtan Bregas |
| Shkolla e mesme e bashkuar “ Nazif Zhavari” Kafaraj |
| Shkolla 9-vjeçare “Riza Braka” Sheq.Musalalaj |
| Shkolla fillore CU Ade (Vartëse Sheq Musalalaj) |
| Shkolla fillore CU Kashisht (Vartëse Sheq Musalalaj) |

Kopshtet

Aktualisht, në territorin e njësisë funksionojnë **7 kopshte**, të vendosura në zona të ndryshme me qëllim që çdo familje të ketë mundësi të barabarta për të përfituar nga këto shërbime. Përveç rolit të tyre edukativ, këto kopshte përbëjnë një mbështetje të rëndësishme sociale për prindërit dhe komunitetin, duke kontribuar në përgatitjen e fëmijëve për arsimin bazë dhe në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe nxitës për zhvillimin e tyre të hershëm.

Lista e kopshteve përfshin:

| Emri i kopshtit |
|-------------------------|
| Kopshti Kafaraj |
| Kopshti Peshtan I Madh |
| Kopshti Peshtan Bregas |
| Kopshti Frakull E Madhe |
| Kopshti Sheq Musalalaj |
| Kopshti Frakull e Vogël |
| Kopshti Kashisht |

Njësia Administrative: Topojë

Shkollat

Në territorin e kësaj njësie administrative funksionojnë gjithsej 2 shkolla, të organizuara në mënyrë të tillë që të plotësojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal në mënyrë të barabartë dhe të qëndrueshme. Ndër këto institucione, 1 është shkollë 9-vjeçare që ofrojnë ciklin e plotë bazë të arsimit, ndërsa 1 janë shkollë e mesme e bashkuar që u ofrojnë të rinjve mundësinë për të vazhduar arsimin e lartë.

Ky rrjet shkollash është shpërndarë në mënyrë të tillë që të garantojë akses në arsim për fëmijët dhe të rinjtë, pavarësisht vendbanimit të tyre, duke mbuluar si zonat urbane ashtu edhe ato periferike apo rurale. Përmes kësaj strukture arsimore të larmishme, njësia kontribuon në forcimin e kohezionit social, rritjen e nivelit të arsimit dhe përmirësimin e kushteve për zhvillim individual dhe komunitar.

Lista e shkollave përfshin:

| Emri i Shkolles |
|---|
| Shkolla 9- vjeçare "Lili Stavre" Topojë |
| Shkolla e mesme e bashkuar "Andon Profka" Seman |

Kopshtet

Aktualisht, në territorin e njësisë funksionojnë **4 kopshte**, të vendosura në zona të ndryshme me qëllim që çdo familje të ketë mundësi të barabarta për të përfituar nga këto shërbime. Përveç rolit të tyre edukativ, këto kopshte përbëjnë një mbështetje të rëndësishme sociale për prindërit dhe komunitetin, duke kontribuar në përgatitjen e fëmijëve për arsimin bazë dhe në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe nxitës për zhvillimin e tyre të hershëm.

Lista e kopshteve përfshin:

| Emri i kopshtit |
|--|
| Kopshti i shkollës 9- vjeçare "Lili Stavre" Topojë |
| Kopshti Sheqmarinas |
| Kopshti Seman |
| Kopshti Seman I Ri |

Njësia Administrative:

Portëz

Shkollat

Në territorin e kësaj njësie administrative funksionojnë gjithsej 4 shkolla, të organizuara në mënyrë të tillë që të plotësojnë nevojat arsimore të komunitetit lokal në mënyrë të barabartë dhe të qëndrueshme. 4 janë shkolla 9-vjeçare që ofrojnë ciklin e plotë bazë të arsimit.

Ky rrjet shkollash është shpërndarë në mënyrë të tillë që të garantojë akses në arsim për fëmijët dhe të rinjtë, pavarësisht vendbanimit të tyre, duke mbuluar si zonat urbane ashtu edhe ato periferike apo rurale. Përmes kësaj strukture arsimore të larmishme, njësia kontribuon në forcimin e kohezionit social, rritjen e nivelit të arsimit dhe përmirësimin e kushteve për zhvillim individual dhe komunitar.

Lista e shkollave përfshin:

| Emri i Shkolles |
|---|
| Shkolla 9 - vjeçare "Naun Kacaku" Portez |
| Shkolla 9 - vjeçare "5 Dëshmoret" Patos Fshat |
| Shkolla 9 - vjeçare "Shyqyri Behari" Kraps |
| Shkolla 9 - vjeçare "Tre Dëshmoret" Lalar (vartëse) |


Kopshtet

Aktualisht, në territorin e njësisë funksionojnë **7 kopshte**, të vendosura në zona të ndryshme me qëllim që çdo familje të ketë mundësi të barabarta për të përfituar nga këto shërbime. Përveç rolit të tyre edukativ, këto kopshte përbëjnë një mbështetje të rëndësishme sociale për prindërit dhe komunitetin, duke kontribuar në përgatitjen e fëmijëve për arsimin bazë dhe në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe nxitës për zhvillimin e tyre të hershëm.

Lista e kopshteve përfshin:

| Emri i kopshtit |
|--|
| Kopshti Portëz |
| Kopshti Portëz E Re |
| Kopshti i shkollës 9- vjeçare "5 Dëshmorët", Patos Fshat |
| Kopshti i shkollës 9- vjeçare "Shyqyri Behari", Kraps |
| Kopshti Plyk |
| Kopshti i shkollës 9- vjeçare "3 Dëshmoret", Lalar |

5. Vizioni, qëllimet strategjike, objektivat dhe përmbledhja e ndërhyrjeve për përmirësimin e Arsimit Parauniversitar



Vizioni

“Të garantojmë një sistem arsimor të barabartë, gjithëpërfshirës dhe cilësor për çdo fëmijë dhe të ri në territorin e Bashkisë Fier, përmes zgjerimit të aksesit, fuqizimit të institucioneve edukative si qendra komunitare, rritjes së kapaciteteve profesionale dhe mbështetjes së diferencuar për grupet në nevojë, me synim ndërtimin e një shoqërie më të drejtë, të zhvilluar dhe socialisht të qëndrueshme.”

Qëllimi i Planit të Arsimit Parauniversitar

Të përcaktojë objektivat dhe veprimet konkrete për realizimin e vizionit, duke harmonizuar politikat vendore me programin qeveritar dhe duke krijuar një platformë strategjike për zhvillim të qëndrueshëm të arsimit parauniversitar në Fier.

Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar është një dokument strategjik dhe operativ i hartuar në nivel lokal, që përcakton objektivat afatmesme dhe afatgjata për zhvillimin e sistemit arsimor në territorin e qytetit të Fierit.

Ky plan:

- parashikon dhe planifikon nevojat arsimore të komunitetit në nivel lokal;

- koordinon burimet njerëzore, financiare dhe infrastrukturore;
- ndihmon në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënies përmes rijimit të kushteve fizike falë investimeve;
- siguron përfshirje gjithëpërfshirëse dhe barazi në arsim;
- mbështet rritjen e aksesit në arsim cilësor.

Vizioni i Bashkisë Fier siguron parimet e barazisë dhe diversitetit, që mundëson formim cilësor të fëmijëve dhe nxënësve në edukim përmes zgjerimit të rrezes së këtij shërbimi në qytet, duke kontribuar të arrijë kushte më të mira për mirërritjen dhe mirëqenien e tyre, mundësi integrimi në tregun e punës dhe mundëson forcimin e karakterit demokratik e përgatitjen e tyre si përfaqësues të denjë në kuadër të integritit në Bashkimin Europian.

Qëllimi i dokumentit “Plani Vendor i arsimit parauniversitar, bashkia Fier” është të përcaktojë objektivat dhe të ndërtojë planin e veprimit për përmbushjen e vizionit të caktuar. Bashkia Fier është në përputhje të programit qeverisë, i cili vazhdon të ketë në fokus të veçantë fushën e arsimit, si një e mirë kombëtare dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e çdo qytetari. Nevoja për hartimin e këtij plani e vendos pushtetin lokal (në këtë rast bashkinë Fier) përpara hartimit të politikave dhe strategjive afatgjata, të cilat do të jenë në funksion të mbështetjes së punës për të siguruar mirëqenie dhe mbështetje cilësore për fëmijët e nxënësit. Për të realizuar mbarëvajtjen e politikave, bashkia Fier synon të planifikojë strategjitë dhe politikat vendore për përmirësimin e cilësisë së shërbimit që ofrohet për arsimin parauniversitar, duke identifikuar fillimisht nevojat dhe kërkesat për përmirësim, konsultimet me grupet e interesit, kostimin e planit dhe indikatorët e monitorimit dhe vlerësimit për zbatimin e tij.

Qëllimi i planifikimit: Ky plan ka për qëllim të identifikojë nevojat për përmirësim dhe ndërhyrje në veprimtarinë që ushtrojnë institucionet e arsimit parauniversitar: parashkollor, bazë, arsimit mesëm i përgjithshëm dhe arsimit profesional, duke u fokusuar në sigurimin dhe përmirësimin e kushteve dhe kapaciteteve organizuese e menaxhuese të këtyre institucioneve, nëpërmjet hartimit të një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse, e cila do të krijojë bazat për zhvillim të qëndrueshëm për vitet në vijim, në funksion të përmirësimit të kushteve të arsimit dhe mundësive për të zhvilluar aftësitë dhe vlerat e kërkuara nga shoqëria.

Metodologjia

Për realizimin e këtij plani u hartua urdhri i Kryetarit të Bashkisë Fier për ngritjen e grupit të punës, i cili konsiston në pjesëmarrjen e: specialistë dhe ekspertë të fushës në institucionin e bashkisë Fier, specialistë të infrastrukturës arsimore, që kanë analizuar në mënyrë të detajuar gjendjen e shkollave ndër vite; përfaqësues të fushës së financës, që kanë vlerësuar burimet dhe kapacitetet buxhetore; si dhe specialistë të administratës, të cilët ndjekin në mënyrë të përditshme problematikat dhe nevojat e institucioneve arsimore, përfshirë mirëmbajtjen dhe funksionimin e tyre, drejtues të institucioneve të bashkisë, drejtues të institucioneve arsimore parauniversitare nën juridiksionin e bashkisë, përfaqësues të këshillit bashkiak, përfaqësues nga organizata të ndryshme si pjesë e grupeve të interesit. Angazhimi i pjesëtarëve të grupit të punës ka qenë rigoroz

dhe me impakt ndjeshmërie për një fushë të rëndësishme dhe me traditë për të gjithë banorët e qytetit të Fier, siç është arsimit. Gjatë punës për përgatitjen e dokumentit janë realizuar një sërë konsultimesh me aktorë dhe bashkëpunëtorë të rëndësishëm në nivel të vetëqeverisjes vendore dhe grupeve të interesit.

Dokumenti “Plani i Arsimit Parauniversitar” është përpjekur të ndërlidhë në një kuadër të integruar analizën e thelluar të gjendjes aktuale, parashikimin e nevojave të tanishme dhe të ardhshme të bashkisë së Fier, nevojat për ndërhyrje dhe koordinimin e ideve të studimit me politikën kombëtare dhe lokale.

Shtyllat udhëheqëse të vizionit:

1. **Zgjerimi dhe barazimi i aksesit në arsim:** Kjo shtyllë synon të garantojë që çdo fëmijë dhe i ri në territorin e Bashkisë Fier, pavarësisht zonës ku jeton, gjinisë apo statusit social-ekonomik, të ketë mundësi të barabartë për të ndjekur një institucion arsimor. Investimet në ndërtimin e shkollave të reja si dhe rikonstruksioni i objekteve ekzistuese, janë të lidhura drejtpërdrejt me këtë prioritet. Shpërndarja e institucioneve në zona të ndryshme reflekton përpjekjen për të eliminuar boshllëqet territoriale dhe për të sjellë arsimin më afër çdo komuniteti.
2. **Përmirësimi i cilësisë së mjedisit mësimor dhe infrastrukturës:** Përmes investimeve në orendi, pajisje, kondicionerë, laboratorë dhe ambiente funksionale, kjo shtyllë synon të krijojë kushte të sigurt, të rehatshme dhe të motivuara për mësimdhënie dhe të nxënie. Ndërtimi i godinave të reja moderne për shkolla të bashkuara dhe profesionalizimi i hapësirave në kopshtet dhe shkollat 9-vjeçare janë komponentë kyç për përmirësimin e përvojës edukative të fëmijëve. Cilësia e mjedisit fizik është trajtuar si një element jetik për mësimdhënie efektive dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të sistemit arsimor lokal.
3. **Gjithëpërfshirja dhe mbështetja e grupeve në nevojë:** Një nga drejtimet thelbësore të vizionit është ndërtimi i një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, që nuk përjashton asnjë fëmijë për shkak të moshës, aftësive ndryshe, përkatësisë etnike apo gjendjes ekonomike. Prania e mësuesve ndihmës, investimet në konvikte dhe pajisje mbështetëse, si dhe përqendrimi në kopshtet publike, përbëjnë mekanizma për të forcuar përfshirjen sociale dhe barazinë në arsim. Kjo shtyllë synon të zbusë pabarazitë dhe të garantojë kushte për çdo fëmijë që të ndjekë edukimin në mënyrë dinjitoze.
4. **Forcimi i rolit të institucioneve arsimore si qendra komunitare dhe ndërlidhëse sociale:** Shkollat dhe kopshtet nuk janë vetëm hapësira mësimi, por gjithashtu funksionojnë si **qendra komunitare**, ku zhvillohen marrëdhënie sociale, mbështeten prindërit, fuqizohen lidhjet komunitet-institucion dhe përçohen vlera demokratike. Ndërtimi i objekteve të integruara, rikonstruksioni i plotë i shkollave dhe pajisja me mjete bashkëkohore janë indikatorë të qasjes komunitare që synon kjo shtyllë. Ato synojnë të bëjnë shkollën një hapësirë të hapur, tërheqëse dhe të vlefshme për komunitetin më të gjerë.

Përmbledhje e Qëllimeve, Objektivave dhe Aktiviteteve

Qëllimi 1: Përmirësimi i infrastrukturës arsimore dhe kushteve themelore për një mjedis mësimor cilësor, të sigurt dhe gjithëpërfshirës.

Objektivat:

- ❖ **Objektivi 1.1:** Sigurimi i funksionimit të përditshëm të kopshteve dhe shkollave përmes mobilizimit të duhur dhe të nevojshëm të burimeve njerëzore të kualifikuara (stafit arsimor dhe atij të shërbimeve mbështetëse), ofrimit të shërbimeve bazë si ngrohje, higjenë, ushqim, transport, furnizime me materiale.
- ❖ **Objektivi 1.2:** Realizimi i ndërhyrjeve infrastrukturore dhe rikonstruksioneve në institucionet ekzistuese arsimore, si dhe pajisja me teknologji dhe mjete didaktike moderne për të rritur cilësinë e procesit mësimor dhe efikasitetin menaxherial.

Qëllimi 2: Zhvillimi i gjithëpërfshirës dhe rritja e cilësisë së edukimit në arsimin parashkollor dhe atë bazë.

Objektivat:

- ❖ **Objektivi 2.1:** Rritja e cilësisë së edukimit në institucionet parashkollore dhe ato 9-vjeçare përmes zhvillimit profesional të vazhdueshëm të stafit edukativ dhe përditësimit të mjeteve mësimore.
- ❖ **Objektivi 2.2:** Zgjerimi i shërbimeve mbështetëse, i rrjetit të mësuesve ndihmës dhe punonjësve psiko-socialë për fëmijët me aftësi ndryshe, me synim integrimin dhe mbrojtjen sociale.
- ❖ **Objektivi 2.3:** Forcimi i bashkëpunimit mes shkollës, familjes dhe komunitetit, përmes strukturave këshilluese dhe aktiviteteve sensibilizuese për rritjen e pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe në jetën institucionale.

Qëllimi 3: Promovimi i zhvillimit kulturor, emocional dhe shoqëruar të fëmijëve përmes aktiviteteve jashtëkurrikulare dhe lidhjes me komunitetin.

Objektivat:

- ❖ **Objektivi 3.1:** Organizimi i aktiviteteve edukative, kulturore, sportive dhe artistike si pjesë integrale e jetës shkollore dhe zhvillimit të gjithanshëm të fëmijëve dhe nxënësve.
- ❖ **Objektivi 3.2:** Ngritja e partneriteteve të qëndrueshme me Institucionet lokale, organizatat rinore, artistike dhe sportive, me qëllim diversifikimin e ofertës edukative dhe integrimin e institucioneve arsimore në jetën komunitare.

Planifikimi i burimeve financiare

Për zbatimin me sukses të Planit të Arsimit Parauniversitar në Bashkinë Fier, është thelbësor planifikimi i saktë dhe konkret i burimeve financiare. Buxheti i parashikuar do të mbulojë realizimin e objektivave strategjike dhe aktiviteteve kryesore të planit, duke përfshirë investimet në infrastrukturë, përmirësimin e kushteve mësimore, zhvillimin profesional të mësuesve, si dhe mbështetjen për nxënësit në nevojë.

Burimet financiare vendore

Bashkia siguron financim për arsimin bazuar në të ardhurat përmes transfertave specifike dhe të përgjithshme të siguruara nga qeveria qendrore si dhe nga taksat dhe tarifat vendore. Transferimet specifike mbulojnë zërat e mëposhtëm:

- Arsimi parashkollor: përfshirë pagat e stafit arsimor dhe ndihmës, kostot e mirëmbajtjes dhe funksionimin e infrastrukturës së kopshteve, si dhe mbështetjen për përfshirje të fëmijëve nga grupe vulnerabël.
- Arsimi 9-vjeçar dhe arsimi i mesëm: përfshirë pagat për punonjësit ndihmës, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së shkollave;
- Arsimi profesional përfshin ofrimin e shërbimet për nxënësit e arsimit profesional që frekuentojnë dhe konviktet;
- Funksionimin e Qendrës kulturore të fëmijëve ose njësi të tjera mbështetëse të edukimit jashtëshkollor, duke përfshirë paratë e personelit mësues dhe ndihmës, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës.

Të dhënat financiare janë të raportuara në mijë lekë dhe pasqyrojnë kontributin për secilën kategori për vitin aktual, si dhe për vitet e mëparshme për të mundësuar analizë krahasimore. Ky informacion është i domosdoshëm për të kuptuar financimin buxhetor të shërbimit të arsimit parauniversitar, mënyrën e plaifikuar të përdorimit të fondeve publike për arsimin parauniversitar, si dhe për të identifikuar boshllëqet ose mundësitë për investime të reja në funksion të përmirësimit të cilësisë së edukimit.

❖ ANALIZA E REALIZIMIT TË BUXHETIT PËR ARSIMIN 2025


| Fondet Buxhetore te miratuara per vitin 2025 | | | | | | |
|--|--|------------------------|--------------------|------------|----------------|------------------------|
| Kodi | Emertimi i Institucionit / Programit | Granti i PaKush tëzuar | Granti i Sektorial | Të Ardhura | Të Trashëguara | Totali i Buxhetit 2025 |
| | | | | | | |
| 09120 | Arsimi Baze (parashkollori +staf mbështetës) | | 301,135,000 | | 500,000 | 301,635,000 |
| 09230 | Arsimi i Mesem (konvikti +staf mbështetës) | | 37,468,994 | 1,779,006 | 200,000 | 39,448,000 |

| Nr | Emri i programit | Buxheti Realizuar 12-M _2022 | Buxheti Realizuar 12-M _2023 | PBA 2024 | PBA Plan Viti 2025 | Buxheti Mirat ar Fillestar 2025 | Buxheti rishikuar + fonde te trasheguarra 2025 | Buxheti realiz 4_M e III të 2025 |
|----|---|------------------------------|------------------------------|---------------|--------------------|---------------------------------|--|----------------------------------|
| | Qendra Ekonomike e Arsimit | Ne 000 /lekë | (Në 000/lekë) | (Në 000/lekë) | (Në 000/lekë) | (Në 000/lekë) | (Në 000/lekë) | (Në 000/lekë) |
| 1 | Arsimi Baze (parashkollori+staf mbështetës) | 211,752 | 228,401 | 240,248 | 301,135 | 301,135 | 301,635, | 285,059 |
| 2 | Arsimi i Mesem (konvikti +staf mbështetës) | 30,511 | 29,584 | 36,248 | 39,248 | 39,248 | 39,448 | 36,433 |

BUXHETI I REALIZUAR NDER VITE



Përmbledhje e shpenzimeve – Viti buxhetor 2025



Gjatë vitit 2025, aktiviteti operacional i Qendrës Ekonomike të Arsimit Fier është financuar nga buxheti i shtetit dhe fondet e Bashkisë Fier, në kuadër të llogarisë ekonomike, janë përfshirë shpenzimet për punonjësit e administratës dhe sektorit mbështetës (sanitare, roje dhe punonjës çerdhe). Shpenzimet për mallra dhe shërbime, me qëllim garantimin e funksionimit normal të institucioneve arsimore në varësi, me një fond total prej **56,804,178 lekë**.

Fondet janë orientuar kryesisht drejt mbulimit të shërbimeve bazë, ku përfshihen furnizimi me ushqime për kopshte dhe çerdhe, pagesat e qirave për objektet e përdorura për arsimin parashkollor, si

dhe sigurimi i shërbimeve të domosdoshme si ujë, internet, transport ushqimesh dhe materiale higjieno-sanitare.

Gjithashtu, janë mbuluar shpenzime për materiale kancelarie, mirëmbajtje, dekor dhe aktivitete edukative me karakter kulturor, të cilat kanë mbështetur funksionimin administrativ dhe cilësinë e shërbimeve në institucionet arsimore.

Në tërësi, përdorimi i fondeve ka synuar sigurimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e procesit edukativ dhe mirëfunksionimin e rrjetit të institucioneve arsimore të Bashkisë Fier.

Përmbledhje e investimeve kapitale të realizuara për vitin 2025

Projekti i pajisjeve profesionale të kuzhinave të kopshteve në vlerën 6,000,000 lekë në përmirësimin e kushteve të punës, rritjes së përmirësimit të shërbimit të ushqimit, ofrimit në kohë dhe cilësisë së duhur tek fëmijët. Ky projekt është parashikuar për tre vitet e ardhshme të hartimit të PBA-së me qëllim edhe përmbushja e standarteve të ndërtesave të kopshtit dhe krijimin e kushteve optimale të punës për stafin (kuzhinieret, ndihmës guzhinieret, pjatalareset) parashikuar për kopshtet e qytetit me ushqim. Realizuar në vlerën 5,263,980 lekë. Është realizuar furnizimi për nëntë institucione (kopshte & çerdhet me ushqim), me soba profesionale (8 copë), Frigorifer Banak me dy dyer & tre dyer, profesional për kuzhinat e kopshteve (2 copë), si dhe Lavaman me 2 vaska me raftë poshtë (3 copë).

Për të realizuar mbrojtjen nga zjarri, shërbimin e sigurisë në objekte si një detyrim ligjor realizuar në vlerën 410,000 lekë, furnizuar institucionet e arsimit bazë, të mesëm dhe parashkollor.

Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese, blerje kondicioner, realizuar në vlerën 676,944 lekë. Duke përmirësuar në këtë mënyrë infrastrukturën e institucioneve parashkollore.

Blerje e librave artistike për nxënësit e shkollave të arsimit fillor, 9 vjecar dhe të mesme Bashkia Fier në vlerën 900 000 lekë.

Furnizim, vendosje kondicioneresh për Bashkinë Fier, shkolla «Janaq Kilica»; shkolla «Liri Gero»; shkolla «Naim Frasheri» Bashkia Fier në vlerën 8 439 720 lekë.

Terrene sportive (furnizim/vendosje bar sintetik 5cm për rehabilitimin e terreneve sportive), është realizuar në masën 3,730 mijë leke.

Kolaudim objekti : Rikonstruksion I Shkolles 9-vjecare "Naim Frasheri", me vlerë 52 mijë leke;

Mbikqyrje për objektin "Rikonstruksion I shkolles 9- vjecare "Naim Frasheri", me vlerë 436 mijë leke;

Kolaudim i punimeve të objektit "Rikonstruksion I Shkolles se Mesme "Janaq Kilica", me vlerë 66 mijë leke;

Mbikqyrje të punimeve të objektit "Rikonstruksion I Shkolles se Mesme "Janaq Kilica" , me vlerë 656 mijë leke;

Përmbledhje e shpenzimeve – Viti buxhetor 2026-2030

Viti 2026

Shpenzimet për mbështetjen e personelit edukator dhe të shërbimit të sistemit parashkollor (paga/sigurime shoqerore),mbështetjen e personelit mbeshtetes për arsimin bazë dhe të mesëm (paga/sigurime shoqerore) dhe stafi I drejtorise në vlerën **469 534 930 lekë**.Planifikuar shpenzime për mbështetje për infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse të arsimit parashkollor,bazë dhe të mesëm,mirëmbajtje e zakonshme e objekteve arsimore (Bojatisja) në vlerë **120,443,961 lekë**. Fondet janë orientuar kryesisht drejt mbulimit të shërbimeve bazë, ku përfshihen furnizimi me ushqime për kopshte dhe çerdhe, pagesat e qirave për objektet e përdorura për arsimin parashkollor, ujë, internet, transport ushqimesh dhe materiale higjieno-sanitare si më poshtë vijon : Pajisja me mjete didaktike moderne në vlerë **7,519,800 lekë**, Materiale per mirmbajtjen e objekteve (kopshte , shkolla dhe cerdhe) në vlerën **33,833,758 lekë**, materiale per pastrim ,dizifektim ,ngrohje në vlerë **5,000,000 lekë**, Materiale inventar i imet per kopshte,çerdhe e konvikte (batanije ,çarcaf,etj) në vlerë **3,000,000 lekë**.Gjithashtu janë planifikuar fonde edhe për veshje pune,material të përgjithshme,kancelari ,mjete pune , (Bojra printeri), bojra dhe materiale per vizatime murale ne kopshte dhe cerdhe etj.

Për periudhën 2026 buxheti total i planifikuar për arsimin parauniversitar është 636,678,891 lekë të shpërndara si më poshtë:

| | 600 - Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli | 601 - Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore | 602 - Mallra dhe sherbime te tjera | 606 - Transfera per buxhetet familiare dhe individet | 231 - Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupëzuara | Totali |
|--|---|--|------------------------------------|--|---|-------------|
| Bashkia Fier (0909) | 402,289,229 | 67,245,701 | 120,443,961 | 2,500,000 | 44,200,000 | 636,678,891 |
| V912AAF - Fëmijë që Frekuentojnë Qendrat Kulturore të Fëmijëve | 10,456,100 | 1,809,569 | - | - | - | 12,265,669 |
| V912AAA - Shërbime Mbështetëse të Stafit të Arsimit Bazë | 282,786,000 | 47,225,262 | - | 1,300,000 | - | 331,311,262 |
| V912AAB - Objekte të Arsimit Baze dhe Parashkollor të Mirëmbajtura dhe Funktionale | - | - | 4,880,000 | - | - | 4,880,000 |
| V912AAE - Edukatorë të Kualifikuar/Trajnuar | - | - | 120,000 | - | - | 120,000 |
| V923AAA - Shërbime Mbështetëse të Stafit të Arsimit të Mesëm të Përgjithshëm | 33,177,564 | 5,540,653 | - | 400,000 | - | 39,118,217 |
| V923AAF - Nxënës të Akomoduar në Konvikt | - | - | 4,874,569 | - | - | 4,874,569 |
| V043AAC - Fëmijë që Frekuentojnë Çerdhet | 75,869,565 | 12,670,217 | 95,982,000 | 800,000 | - | 185,321,782 |
| V912AAD - Fëmijë që Ndjekin Kopëshin | - | - | 14,587,392 | - | - | 14,587,392 |
| Shpenzime Pajisje | - | - | - | - | 5,000,000 | 5,000,000 |
| Shpenzime inventar ekonomik | - | - | - | - | 8,200,000 | 8,200,000 |
| Bashkëfinancim rikonstruksione shkollash dhe terrene sportive (1110346) | - | - | - | - | 10,000,000 | 10,000,000 |
| Terrene sportive (minifushat) | - | - | - | - | 21,000,000 | 21,000,000 |

Viti 2026

| Kodi i llogarisë | Llogaria | Shuma (lekë) |
|------------------|---|--------------|
| 600 | Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli | 402,289,229 |
| 601 | Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore | 67,245,701 |
| 602 | Shpenzime korrente, mallra dhe shërbime | 120,443,961 |
| 606 | Transferim tek individet | 2,500,000 |
| 231 | Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara | 44,200,000 |

Përmbledhje e investimeve kapitale (2026–2030)

Plani i investimeve kapitale i Bashkisë Fier për arsimin parauniversitar për periudhën 2026–2030 është ndërtuar mbi objektivin e përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese, ndërtimit të godinave të reja, pajisjes së institucioneve arsimore me orendi dhe logjistikë moderne, si dhe garantimit të kushteve të sigurta për fëmijët dhe të rinjtë në procesin edukativ. Gjatë periudhës 2026–2030, investimet do të fokusohen në rikonstruksionin e shkollave të arsimit bazë, parashkollor dhe të mesëm, pajisjen e ambienteve me infrastrukturë moderne, si dhe ngritjen e kushteve të përshtatshme për mësimdhënie dhe zhvillim gjithëpërfshirës të nxënësve. Bashkia Fier synon të garantojë ambiente të sigurta, funksionale dhe të përshtatshme për nevojat e fëmijëve dhe të rinjve në çdo nivel të arsimit parauniversitar. Këto ndërhyrje janë pjesë e një vizioni afatgjatë për transformimin e shkollës në një hapësirë që promovon cilësi, barazi dhe zhvillim të qëndrueshëm arsimor në territorin e Bashkisë Fier. Një nga projektet më të mëdha financiare është rikonstruksioni i shkollave të arsimit bazë dhe parashkollor (në vitin 2026 shkolla 9- vjeçare "Mark Dashi" dhe "Qemal Mehmetaj" Cakran), për të vazhduar më vonë edhe në ndërhyrjen e institucioneve të tjera. Bashkia Fier ka një rrjet të gjerë shkollash në zonat rurale, ku sfidat infrastrukturore dhe kushtet gjeografike ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë dhe aksesin në arsim. Për të ndërtuar një qasje të drejtë dhe të qëndrueshme investimi, është realizuar një analizë e thelluar që kombinon: (1) emergjencën e ndërhyrjes, dhe (2) numrin e përfituesve, si dy kritere bazë për vendosjen e prioriteteve. **Prioritet shumë i lartë (ndërhyrje emergjente):** Lageshtirë, izolim i dobët, Tualete të amortizuara, mungesë termoizolimi, Çati e re, mungesë suvatimi, rrethim i amortizuar, mungesë tualeti. Disa shkolla raportojnë nevoja urgjente për ndërhyrje fizike në: Çati të dëmtuara dhe që rrjedhin, të cilat kërkojnë riparim ose zëvendësim total. Fasada të amortizuara, me suvatim të degraduar ose tulla të ekspozuara. Dritare dhe dyer të dëmtuara, që nuk mbyllën siç duhet ose janë jashtë funksioni, duke rrezikuar sigurinë dhe komoditetin e nxënësve (jane në mirembajtje te vazhdueshem nga ana e Bashkisë Fier)

Prioritet i mesëm: Në këtë grup përfshihen shkollat me pak nxënës, me problematika të kufizuara në mirëmbajtje (bojatisje, lysterje, ndonjë riparim) që nuk ndikojnë rëndë në siguri apo proces mësimor. **Nuk kërkojnë ndërhyrje prioritare:** Shkollat që janë të rikonstruara pas vitit 2015 ose janë shkolla të reja pa asnjë problem të raportuar, nuk kërkojnë fonde kapitale në periudhën afatshkurtër.

Prioritete:

➤ Mungesë ambientesh funksionale

Kërkesë e lartë për krijimin ose përmirësimin e kabineteve mësimore, laboratorëve, bibliotekave dhe klasave për mësim të specializuar. Nevojë për ambiente sportive funksionale, përfshirë kënde sportive, palestra dhe oborre të përshtatshme për aktivitete fizike. Duke shfrytëzuar të gjitha kapacitetet tenike janë realizuar tabela basketbolli në oborret e shkollave. Theksojmë se Bashkia i ka vlerësuar kërkesat e institucioneve arsimore dhe i ka pasur fokus edhe në planifikimin e fondeve buxhetore 2026-2028 si dhe do të mbeten në fokus në vitet 2028-2030.

➤ Emergjencia e problematikës infrastrukturore, ku përfshihen mungesa e kushteve bazë të sigurisë, funksionalitetit, higjienës dhe aksesit për fëmijët me aftësi të kufizuara;

Lehtësira arkitektonike për fëmijët me aftësi të kufizuara,

Rampa dhe tualete të përshtatura për fëmijët me aftësi të kufizuara,

Numri i fëmijëve të regjistruar, si një tregues i ndikimit të ndërhyrjes.

➤ Standardi i sipërfaqes /Metra katrorë për fëmijë në çerdhe kopshte publike dhe shkolla

➤ Përmirësim i klasave dhe sipërfaqeve funksionale në kopshte me më shumë se 25 fëmijë - sidomos në qytet

➤ Rritje e numrit të tualeteve dhe lavamanëve, sipas standardit minimal (1 tualet për 20

fëmijë). Ky investim është prioritet edhe për vitin buxhetor 2026.

- Investime në pajisje didaktike - tavolina, materiale pune, ndarje të brendshme. Kapaciteti i mobilimit (karrige e tavolina)

Çdo fëmijë ka mesatarisht një karrige, që është pozitive. Për tavolinat mesatarisht 2.3 fëmijë ndajnë një tavolinë. Kjo tregon se në shumë kopshte fëmijët nuk kanë tavolina individuale, çka ndikon në aktivitetet që kërkojnë hapësirë personale (vizatime, modelime, lojëra edukative) Megjithatë tavolinat janë të mëdha dhe u lejojnë femijeve që të kenë hapsirë të tyre. Gjithashtu kariket plastike po zëvendësohen me karrike druri të rehatshme dhe të pershtatshme për fëmijet.

- Prioritet i menjëhershëm duhet t'u jepet: Kopshteve me probleme sanitare, ku ndikon drejtpërdrejt në shëndetin e fëmijëve.
- Rasteve ku ka mungesë sigurie fizike (si mungesa e rrethimit).
- Ndërhyrje emergjente (sanitare dhe sigurie)
- Ndërhyrje të planifikuara (infrastrukturë e përgjithshme, suvetime, sistemim oborri)

1. Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parauniversitar

Të ardhurat vendore dhe transferimet nga qeveria qendrore për shërbimin e arsimit parauniversitar

Të dhënat financiare për shërbimin e arsimit parauniversitar

Ky seksion përmbledh informacionin financiar që lidhet me funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të arsimit parauniversitar në nivel bashkie.

Bashkia siguron financim për arsimin bazuar në të ardhurat përmes transfertave specifike dhe të përgjithshme të siguruara nga qeveria qendrore si dhe nga taksat dhe tarifatat vendore. Transferimet specifike mbulojnë zërat e mëposhtëm:

- Arsimi parashkollor: përfshirë pagat e stafit arsimor dhe ndihmës, kostot e mirëmbajtjes dhe funksionimin e infrastrukturës së kopshteve, si dhe mbështetjen për përfshirje në arsimin parashkollor të fëmijëve nga grupe të vulnerabël.
- Arsimi 9-vjeçar Arsimi i mesëm: përfshirë pagat për punonjësit ndihmës, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së shkollave;
- Arsimi profesional përfshin ofrimin e shërbimit për nxënësit e arsimit profesional që frekuentojnë dhe konviktet;

Të dhënat financiare janë të raportuara në mijë lekë dhe pasqyrojnë kontributin për secilën kategori për vitin aktual, si dhe për vitet e mëparshme për të mundësuar analizë krahasimore.

Ky informacion është i domosdoshëm për të kuptuar financimin buxhetor të shërbimit të arsimit parauniversitar, mënyrën e plaifikuar të përdorimit të fondeve publike për arsimin parauniversitar, si dhe për të identifikuar boshllëqet ose mundësitë për investime të reja në funksion të përmirësimit të cilësisë së edukimit.

• **Plani i Veprimit (matrica e aktiviteve)**

Qëllimi 1 (Q1) Përmirësimi i infrastrukturës arsimore dhe kushteve themelore për një mjedis mësimor cilësor, të sigurt dhe të gjithëpërfshirës.

Objektivi O1.1 Sigurimi i funksionimit të përditshëm të kopshteve dhe shkollave përmes mobilizimit të duhur dhe të nevojshëm të burimeve njerëzore të kualifikuara (stafit arsimor dhe atij të shërbimeve mbështetëse), ofrimit të shërbimeve bazë si ngrohje, higjenë, ushqim, transport, furnizime me materiale.

| Aktivite | Periudha e zbatimit | Përgjegjës | Partnerë | Burimet financiare | Tregues |
|--|---------------------|-------------------------------------|-------------------|--|---|
| Mbështetje financiare dhe sigurime për stafin arsimor - Sigurimi i vazhdueshëm i personelit të arsimit parashkollor (edukatore + staf mbështetës), arsimit bazë dhe të mesëm (staf mbështetës), nën administrimin e bashkisë, për të garantuar stabilitetin dhe motivimin e burimeve njerëzore. | 2026–2030 | Njësia përgjegjëse për arsimin, QEA | Këshilli Bashkiak | Transferte specifike + Buxhet vendor Përfshirë në zërin “Paga Shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli” dhe “Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore” | Numër kopshte Nr. i personelit edukativ të arsimit parashkollor. Nr. i stafit mbështetës në arsimin parashkollor, arsimin bazë dhe atw të mesëm. Nr. i fëmijëve të regjistruar në kopësht (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel) që përfitojnë nga shërbimi i arsimit parashkollor. Raporti (%) i fëmijëve të regjistruar në kopshte ndaj numrit të fëmijëve në moshë kopshti resident Raporti (%) i fëmijëve të regjistruar në kopshte nga komunitetet rom dhe egjiptian ndaj numrit total të fëmijëve romë dhe egjiptianë në moshë kopshti që banojnë në territorin e bashkisë |

| | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|
| | | | | | <p>Nr, i fëmijëve të regjistruar në shkollat e arsimit bazë, dhe atij të mesëm (sipas shkollës, sipas ciklit arsimor, vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabël).</p> <p>Raporti (%) i fëmijëve të regjistruar në shkollë nga komunitetet rom dhe egjiptian ndaj numrit total të fëmijëve romë dhe egjiptianë në moshë shkolle që banojnë në territorin e bashkisë</p> <p>Edukator për femije kopshti, numri mesatar i fëmijëve për kopësht (raporti numrit të fëmijëve kundrejt numrit total të kopshteve).</p> <p>Përqindja e edukatorëve femra dhe përqindja e edukatorëve meshkuj në institucionet arsimore parashkollore.</p> <p>Numri mesatar i fëmijëve në një klasë (Raporti numrit total të fëmijëve kundrejt numrit total të grupeve në arsimin parashkollor).</p> <p>Nxënës në klasë: Numri mesatar i nxënësve në një klasë (Raporti numrit total të nxënësve kundrejt numrit total të klasave në arsimin bazë).</p> <p>Raporti i shpenzimeve në institucionin e arsimit bazë kundrejt numrit total të nxënësve të arsimit</p> |
|--|--|--|--|--|--|

| | | | | | |
|---|-----------|---|--|--|--|
| | | | | | bazë dhe parashkollor (mijë lekë/nxënës). Numri i shkollave që i shërbejnë fëmijëve me aftësi të veçanta. |
| Mirëmbajtja sistematike dhe ndërhyrjet emergjente në infrastrukturë. - Zbatimi i programeve të mirëmbajtjes së planifikuar dhe reagimit të shpejtë në raste emergjente, me qëllim ruajtjen e funksionalitetit, sigurisë dhe integritetit të ambienteve arsimore në të gjitha nivelet. | 2026–2030 | Njësia përgjegjëse për arsimin, QEA Njësia përgjegjëse për shërbimet publike dhe investimet. | Shkollat, kopshtet | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Përfshirë në zërin “ <i>Shpenzime Korrente, Mallra dhe shërbime</i> ” | Nr. ndërhyrjeve të realizuara në godina (Lyerje, ndarje ambientesh, elektroshtëpiakesh, kompjuterash, printerash, pajisjesh të zyrave) |
| Sigurimi i standardeve të higjienës në institucionet arsimore - Kryerja e pastrimit të përditshëm dhe aplikimi i masave përmirësuese për të garantuar kushte të pastra, të sigurta dhe të shëndetshme për fëmijët, nxënësit dhe stafin pedagogjik. <i>-Furnizim me bazë materiale të bollshme për higjienën – -Shtim i stafit mbështetës në institucionet arsimore, aty ku paraqitet e nevojshme</i> | 2026–2030 | Njësia përgjegjëse për arsimin, QEA Njësia përgjegjëse për shërbimet publike | Shkollat, opshtet operatorë të higjienës | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Përfshirë në zërin “ <i>Shpenzime Korrente, Mallra dhe shërbime</i> ” | Nr. i shkollave me kushte të përmirësuara higjieno-sanitare Nr. i kopshteve me kushte të përmirësuara higjieno-sanitare |

| | | | | | |
|--|-----------|---|------------------------|---|--|
| Funksionimi i sistemeve të ngrohjes në institucionet arsimore - Instalimi, mirëmbajtja dhe monitorimi i sistemeve të ngrohjes për të siguruar | 2026–2030 | Qendra Ekonomike e Arsimit | Operator të energjisë, | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Përfshirë në zërin “Shpenzime | Nr. i institucioneve arsimore parashkollore, të arsimit bazë dhe atij të mesëm me sistem funksional ngrohjeje |
| mjedise komode dhe të përshtatshme gjatë gjithë sezonit të ftohtë. | | | | <i>Korrente, Mallra dhe shërbime”</i> | Numri i shkollave që ngrohen me dru zjarri Numri i shkollave që ngrohen me kaldaja dhe naftë dhe gaz |
| Pajisja e shkollave dhe kopshteve me materiale kancelarie - Furnizimi i rregullt i institucioneve arsimore me mjete administrative dhe logjistike të nevojshme për funksionimin e përditshëm dhe realizimin efektiv të procesit mësimor. | 2026–2030 | Qendra Ekonomike e Arsimit | Shkollat | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Përfshirë në zërin “Shpenzime <i>Korrente, Mallra dhe shërbime”</i> | Nr. i institucioneve të arsimit parauniversitar të furnizuara me kancelari (sipas llojit, ciklit të arsimit) |
| Sigurimi i kushteve për mbrojtje nga zjarri - Kontrolli periodik, kolaudimi dhe mirëmbajtja e fikseve të zjarrit në ambientet arsimore, për të përmbushur standardet e sigurisë dhe ndërhyrjes emergjente. | 2026–2030 | Qendra Ekonomike e Arsimit Zyra e Emergjencave | Zjarrfikësja, NjA | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Përfshirë në zërin “Shpenzime <i>Korrente, Mallra dhe shërbime”</i> | Nr. i fikseve të vendosura dhe funksionale në institucionet arsimore parauniversitare; Nr. i institucioneve arsimore parauniversitare (sipas llojit, ciklit arsimor) në kushte të sigurta përsa i përket pajisjes me fikse zjarri; Numri i shkollave me shërbim sigurie; |

| | | | | | |
|---|-----------|---------------------------------------|---|---|---|
| Furnizimi me dokumentacion zyrtar për institucionet arsimore Prokurimi dhe shpërndarja e formularëve, regjistrave dhe dokumenteve të tjera të nevojshme për administrimin | 2026–2030 | Njësia përgjegjëse për arsimin | Shkollat | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Përfshirë në zërin “ <i>Shpenzime Korrente, Mallra dhe shërbime</i> ” | Nr. i shkollave/kopshteve të pajisura me dokumentacion |
| dhe arkivimin institucional të shkollave dhe kopshteve. | | | | | |
| Pajisja me mjete didaktike moderne - Mbështetja e procesit mësimor përmes pajisjes së kopshteve me mjete didaktike bashkëkohore që përmirësojnë përvojën e të nxënit dhe zhvillojnë kompetencat e fëmijëve. | 2026–2030 | Njësia përgjegjëse për arsimin QEA | Kopshtet MA | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike Përfshirë në zërin “ <i>Shpenzime Korrente, Mallra dhe shërbime</i> ” Donacione, prindërit | Nr. i institucioneve të arsimit parashkollor të pajisura me mjete didaktike |
| Sigurimi i ushqimit për fëmijët në institucionet parashkollore - Ofrimi i vakteve të balancuara dhe të shëndetshme në mënyrë të rregullt për fëmijët që frekuentojnë kopshtet publike, duke garantuar kujdesin ushqimor si pjesë e edukimit të hershëm. <i>Në bashkinë Fier të gjithë mensat janë funksionale. - Shtimi i numrit të fëmijëve që marrin këtë shërbim, sipas</i> | 2026–2030 | Zyra Shëndetit Publik & Arsimit | Operatorët e licencuar, Ministria e Arsimit, Sportit (MA) | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Përfshirë në zërin “ <i>Shpenzime Korrente, Mallra dhe shërbime</i> ” | Numri i kopshteve me drekë |

| | | | | | |
|---|------------------|---|--|--|---|
| <p><i>kërkesës dhe pas realizimit të një analize të nevojës</i></p> | | | | | |
| <p>Dezinfektimi i institucioneve arsimore - Zbatimi i shërbimeve periodike të dezinfektimit në të gjitha ambientet arsimore, në përputhje me protokollet higjieno-sanitare për të mbrojtur shëndetin e fëmijëve dhe stafit.</p> | <p>2026–2030</p> | <p>Njësia përgjegjëse për arsimin Njësia përgjegjëse për shërbimet publike</p> | <p>Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), operatorë të kontraktuar</p> | <p>Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Përfshirë në zërin “<i>Shpenzime Korrente, Mallra dhe shërbime</i>”+ fond emergjence</p> | <p>Nr. i dezinfektimeve të kryera në vit në secilin institucion arsimor parauniversitar;</p> |
| <p>11. Sigurimi i logjistikës së transportit për institucionet arsimore - Vënia në dispozicion e mjeteve të transportit dhe mbështetja teknike për nevojat operacionale dhe administrative të institucioneve arsimore që administrohen nga bashkia.</p> | <p>Çdo vit</p> | <p>ZVA</p> | <p>Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i Transporteve,</p> | <p>Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Përfshirë në zërin shërbim transporti dhe “<i>Shpenzime Korrente, Mallra dhe shërbime</i>”</p> | <p>Shpenzime për karburant, siguracione, pjesë këmbimi për automjete të shërbimit të DA, dhe mbështetje për administratën</p> |

Objektivi O1.2 Realizimi i ndërhyrjeve infrastrukturore dhe rikonstruksioneve në institucionet ekzistuese arsimore, si dhe pajisja me teknologji dhe mjete didaktike moderne për të rritur cilësinë e procesit mësimor dhe efikasitetin menaxherial.

| Aktivitete | Periudha e zbatimit | Përgjegjës | Partner ë | Burimet financiare | Tregues |
|---|---------------------|---|-----------|---|--|
| Investime në infrastrukturën e institucioneve të arsimit parauniversitar | | | | | |
| 1. Krijimi i hapsirave për mensat e kopshteve me ushqim | 2026-2030 | Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për projektet dhe investimet publike QEA | Bashkia | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike | Nr. i institucioneve të arsimit parauniversitar; |
| 2. Pajisje audiovizive (Sistem kamerash) | 2026-2030 | Njësia përgjegjëse për arsimin, QEA | Bashkia | Buxhet vendor | Nr. i pajisjeve të furnizuara; Nr.i kopshteve përfitues; |
| 3. Furnizim pajisje kuzhine dhe lvanteri për kopshtet | 2026-2030 | Njësia përgjegjëse për arsimin, QEA | Bashkia | Buxhet vendor | Nr. i pajisjeve të furnizuara; Nr.i kopshteve përfitues; |
| 4. FV orendi mobilje për kopshtet | 2026 - .2030 | Njësia përgjegjëse për arsimin, QEA | Bashkia | Buxhet vendor | Nr. i pajisjeve të furnizuara; Nr.i kopshteve përfitues; |
| 5. FV kondicioner për kopshtet dhe institucionet arsimore | 2026 - 2030 | QEA, | Bashkia | Buxhet vendor | Nr.i kopshteve të pajisur me kondicionerë; |
| 6. Blerje Mjet Transporti Frigoriferik (ATV)(1110325) | 2026 - 2030 | QEA, | Bashkia | Buxhet vendor | Nr.i institucioneve të cilat përfitojnë ushqim; |

| | | | | | |
|--|-------------|---|---------|----------------------|--|
| 7. Investime për kende lojrash brenda ambjenteve të kopshteve dhe çerdheve (1110282) | 2026 - 2030 | Njësia përgjegjëse për projektet dhe investimet publike QEA, | Bashkia | Buxhet vendor | Nr.i kopshteve të pajisur me kende lojrash; |
| 8. Ndërhyrja në tualetet e institucioneve arsimore | 2026 - 2030 | Njësia përgjegjëse për projektet dhe investimet publike QEA, | Bashkia | Buxhet vendor | Nr tualeteve te reja ne cdo kat te godines duke krijuar kushte te pershtatshme higjenosantare per stafin dhe fëmijët. Paisja e shkolles me tualete PAK per krijimin e nje standarti gjithepershires ne mesimdhene |
| 9. Rikonstruksione shkollash dhe terrene sportive (1110346) | 2026 - 2030 | Njësia përgjegjëse për projektet dhe investimet publike Bashkia Fier MA | Bashkia | Financim i Brendshëm | Nr Institucioneve arsimore |
| 10. Terrene sportive (minifushat) | 2026 - 2030 | Njësia përgjegjëse për projektet dhe investimet publike QEA, | Bashkia | Buxhet vendor | Nr Institucioneve arsimore |
| 11. Investime për pajisje në godinat e shkollave të arsimit parauniversitar sipas nevojës | 2026 - 2030 | Bashkia Fier QEA, | Bashkia | Buxhet vendor | Nr Institucioneve arsimore |

Qëllimi 2 (Q2) – Zhvillimi i gjithëpërshirës dhe rritja e cilësisë së edukimit në arsimin parashkollor dhe atë bazë.

| Objektivi O2.1 Rritja e cilësisë së edukimit në institucionet parashkollore dhe ato 9-vjeçare përmes zhvillimit profesional të vazhdueshëm të stafit edukativ dhe përditësimit të mjeteve mësimore | | | | | |
|---|----------------------------|---------------------------------|-----------------------------|---|--|
| Aktivitete | Periudha e zbatimit | Përgjegjës | Partnerë | Burimet financiare | Tregues |
| Unifikimi dhe pajisja me materiale didaktike, kompjuterë dhe trajnime për edukatorët dhe fëmijët në kopshte | Çdo vit | Njësia përgjegjese për arsimin, | MA, partnerë zhvillimi | Buxhet vendor + transfertën e pakushtëzuar specifike përfshirë në zërin “ <i>Paga Shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli</i> ” dhe “ <i>Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore</i> ” Organizata partnere të tjera | Nr. i fëmijëve (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabël) që përfitojnë nga mjetet dhe trajnimet |
| Fuqizimi i kapaciteteve të stafit arsimor të institucioneve parashkollore, në funksion të | 2026–2030 | Njësia përgjegjese për arsimin, | MA, institucionet arsimore, | Buxhet vendor + transfertën e pakushtëzuar | Nr. (përqindja) e edukatorëve të trajnuara |

garantimit të një edukimi cilësor dhe mbështetës për zhvillimin e hershëm të fëmijëve.

OSHC,
ASKAP

specifike përfshirë në *“Paga Shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli”* dhe *“Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore”*

Nr. i trajnimeve të realizuara,

Nr.i tematikave të përzgjedhura nga vetë stafi i edukatoreve.

Përmirësimi i praktikave të mësimdhënies;

Përqindja (%) e edukatorëve të trajnuar mbi qasjen e barazisë gjinore dhe gjithëpërfshirjes në arsimin parashkollor, ndaj numrit total të edukatorëve në territorin e bashkisë;

Objektivi O2.2 Zgjerimi i shërimeve mbështetëse dhe i rrjetit të mësuesve ndihmës dhe punonjësve psiko-socialë për fëmijët me aftësi ndryshe, me synim integrimin dhe mbrojtjen sociale

| Aktivitetet | Periudha e zbatimit | Përgjegjës | Partnerë | Burimet financiare | Tregues |
|--|----------------------------|---|---|--|--|
| Angazhimi i mësuesve ndihmës në kopshte | 2026–2030 | Njësia përgjegjëse për arsimin, Njësia përgjegjëse për burimet njerëzore | OJQ sociale, MA | Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike përfshirë në zërin “Paga Shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli” dhe “Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore” | Nr. (përqindja) i fëmijëve (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel) me ndihmë sociale; Nr. (përqindja) i fëmijëve përfitues të mbështetjes me mësues ndihmës; |
| Institucionalizimi dhe funksionalizimi i strukturave menaxhuese pjesëmarrëse dhe këshilluese në institucionet arsimore, përfshirë Bordin e institucionit, Këshillin e Prindërve dhe Komisionin e Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit në kopshtet dhe shkollat. | 2026–2030 | Njësia përgjegjëse për arsimin Drejtoria e Kopshteve | Administratorët e Njësive Administrative; këshilli bashkiak; Kopshtet; Prindërit | Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor) | Struktura menaxhuese në kopshte dhe shkolla aktive Pjesëmarrja e balancuar gjinore e prindërve (nënë/baba) në strukturat menaxhuese të kopshteve dhe shkollave; Raporti gjinor në përqindje (%) i përfaqësuesve të prindërve në bordet e |










| | | | | | |
|---|-----------|---|---|---|--|
| | | | | | institucioneve arsimore (nëna dhe baballarë). |
| Ofrimi i shërbimit psiko-social në kopshte | 2026–2030 | <p>Njësia përgjegjese për arsimin,</p> <p>Njësia përgjegjëse për burimet njerëzore;</p> <p>Njësia përgjegjëse për shërbimet sociale</p> | Kopshtet; OSHC | Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor) | <p>Nr. i fëmijëve (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel) të mbështetur me shërbim psiko social;</p> <p>Përqindja (%) e institucioneve parashkollore që ofrojnë shërbim psiko-social (psikolog dhe/ose punonjës social), ndaj numrit total të institucioneve parashkollore në territorin e bashkisë;</p> <p>Numri i psikologëve dhe/ose punonjësve socialë për çdo 500 fëmijë të regjistruar në institucionet parashkollore (kopshte) në territorin e bashkisë;</p> <p>Raporti i mësuesve ndihmës ndaj numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore parashkollore;</p> |
| Mbështetja e nxënësve nga familjet në nevojë | 2026–2030 | <p>Njësia përgjegjese për arsimin;</p> <p>Njësia përgjegjëse për</p> | Shkollat, Njësitë Administrative, OJQ | Buxhet vendor + donacione + projekte sociale | Nr. i nxënësve (vajza/djem) nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel të mbështetur; |

| | | shërbimet sociale | | | Raporti (%) i rasteve të trajtuara kundrejt rasteve të raportuara për diskriminim gjinor ose social në institucionet arsimore parauniversitare (parashkollore dhe shkollore). |
|---|-----------|--|------------------------|-----------------------------------|---|
| Mbështetja e nxënësve me rezultate të shkëlqyera | 2026–2030 | Njësia përgjegjëse për arsimin; ZVA | MA, mësues, komuniteti | Buxhet vendor + shpërblime nga MA | Nr. i nxënësve (vajza/djem) me rezultate të shkëlqyera të mbështetur |

Objektivi O2.3 Forcimi i bashkëpunimit mes shkollës, familjes dhe komunitetit, përmes strukturave këshilluese dhe aktiviteteve sensibilizuese për rritjen e pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe në jetën institucionale

| Aktivitete | Periodha e zbatimit | Përgjegjës | Partnerë | Burimet financiare | Tregues |
|---|---|--|---|--|--|
| Organizimi i fushatave informuese dhe edukative për prindërit dhe kujdestarët, veçanërisht në lagje dhe fshatra me mungesë informacioni mbi rëndësinë e edukimit të hershëm. | Tremujori II-III 2026, 2027, 2028,2029,2030 | Drejtoria e Arsimit në Bashki | Drejtoria e Shëndetësisë, OJF lokale, Këshillat e Prindërve | Zëri 602 – Mallra dhe shërbime; Donatorë lokalë OSHC | - Numri i fushatave të realizuara - Numri i prindërve të informuar - Rritje e regjistrimeve në kopsht në zonat target |
| Zhvillimi i bashkëpunimit me punonjësit socialë dhe strukturat e mbrojtjes së fëmijës për të identifikuar fëmijët që nuk ndjekin kopshtin për shkak të kushteve ekonomike, kulturore ose sociale, dhe për të ofruar mbështetje të përshtatur.këshilluese në institucionet arsimore, përfshirë Bordin e institucionit, Këshillin e Prindërve dhe Komisionin e Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit në kopshtet dhe shkollat. | Tremujori II-III 2026, 2027, 2028,2029,2030 | Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës, Drejtoria e Arsimit | Qendrat Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, OJF | Zëri 602 dhe 606 – Trajnime dhe koordinim; Projekte të mbështetura | - Numri i fëmijëve të identifikuar - Numri i fëmijëve të përfshirë në shërbim pas ndërhyrjes - Raste të trajtuara përmes planit të mbështetjes |
| Nxitja e përfshirjes së këshillave të prindërve dhe organizatave komunitare lokale në proceset vendimmarrëse, planifikuese dhe monitoruese të shërbimit arsimor, me qëllim rritjen e transparencës dhe Bashkëpronësisë | Tremujori II-III 2026, 2027, 2028,2029,2030 Tremujori II-III 2026, | Drejtoria e Arsimit dhe Institucionet Arsimore | Bordi i Shkollës, Bordi i kopshtit, Këshillat e Prindërve, Komuniteti lokal | Zëri 600 dhe 606 – Orë pune, mbledhje dhe aktivitete komunitare | - Numri i këshillave funksionale - Frekuentimi i takimeve - Propozime të komunitetit të reflektuara në vendimmarrje |

Qëllimi 3 (Q3)– Promovimi i zhvillimit kulturor, emocional dhe shoqëruar të fëmijëve përmes aktiviteteve jashtëkurrikulare dhe lidhjes me komunitetin.

| Objektivi O3.1 Organizimi i aktiviteteve edukative, kulturore, sportive dhe artistike si pjesë integrale e jetës shkollore dhe zhvillimit të gjithanshëm të fëmijëve dhe nxënësve. | | | | | |
|--|---|-----------------------|---------------------|---|---|
| Aktivitete | Periudha e zbatimit | Përgjegjës | Partnerë | Burimet financiare | Tregues |
| Organizimi i aktiviteteve kulturore, sportive, lojëra edukative dhe mbështetje emocionale në institucionet e Arsimit: | Çdo vit sipas kalendarit të aktiviteteve të miratuara në planin e institucioneve arsimore | Shkollat/ kopshtet | Prindër, OJQ, MA | Buxhet vendor, mbështetje donatorësh | Numër dhe larmi aktivitetesh; përfshirje gjithëpërfshirëse; |
| 1. 23–30 Shtator – Java Evropiane e Sportit <ul style="list-style-type: none">  Loja sportive në oborrin e kopshtit (loja popullore)  Ushtrime në natyrë (gimnastikë)  Loja të ndryshme lëvizore, Gara me biçikleta, etj.) | | | | | |
| 2. Prill–Maj – Java Olimpikë <ul style="list-style-type: none">  Loja të ndryshme sportive (stafeta me flamuj, topa)  Gara vrapimi, midis kopshteve në grupe  Gara me biçikleta | | | | | |
| 3. 20 Nëntor – Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve <ul style="list-style-type: none">  Bisedë, postera, aktivitete në natyrë (Kam të drejtë të luaj)  Ekspozitë me materiale të përgatitura nga fëmijët "Të drejtat e mia"  "Unë mbroj të drejtat e mia" (bisedë) | | | | | |

4. Dita e Luftës Kundër Bullizmit (21 nëntor)

🚩 Bisedë me fëmijët

1. Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe

🚩 Postera me gjuhën shqipe & ilustrime

🚩 Koncert për gjuhën shqipe (Gjuha jonë sa e mirë)

2. Dita Ndërkombëtare e Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara (3 dhjetor)

🚩 Biseda sensibilizuese për fëmijët me nevoja të veçanta

🚩 Loja me role (si t'i ndihmojmë shokët me nevoja të veçanta)

🚩 Ekspozitë me punime të përgatitura nga fëmijët me AK

3. Dita Botërore e Gjuhës Amtare

🚩 Vizitë në bibliotekë

4. Dita Botërore e Ujit (UNESCO 22 mars)

🚩 Rëndësia dhe vlerat e ujit (bisedë, prezantime)

🚩 “Uji është jetë” (Postera, eksperiment me ujëra)

🚩 Bisedë për vlerat e ujit

5. Dita Ndërkombëtare e Romëve


🚩 Bisedë për fëmijët romë

6. Zakonet dhe traditat e romëve






7. Dita Botërore e Librit (23 prill)

🚩 Ne dimë të bëjmë libra (aktivitet krijues)


🚩 Vizitë në bibliotekë

 Dhuro një libër, hap një dritare (fushatë sensibilizuese)

8. Dita Botërore e Mjedisit (5 qershor)

-  Ekspozitë me mjete të riciklueshme
-  Mbrojmë tokën, planetin tonë (projekt)
-  Mbjellim lule në oborrin e kopshtit ose në vazo (aktivitet praktik)
-  Mbajmë pastër mjedisin tuaj mësojmë e luajmë (aktivitet praktik, bisedë)
-  Ekskursion në lulishten e qytetit

9. Yjet e Vallzimit

-  Konkurs midis kopshteve të qytetit

Objektivi specifik O3.2 Ngritja e partneriteteve të qëndrueshme me Institucionet lokale, organizatat rinore, artistike dhe sportive, me qëllim diversifikimin e ofertës edukative dhe integrimin e institucioneve arsimore në jetën komunitare.

| Aktivitete | Periudha e zbatimit | Përgjegjës | Partnerë | Burimet financiare | Tregues |
|---|----------------------------|--|--|---|--|
| Organizimi i aktiviteteve kulturore, sportive, lojëra edukative dhe mbështetje emocionale në institucionet e Arsimit: | Çdo vit | Drejtorja e Arsimit dhe Institucionet Arsimore | Prindër, OJQ | Buxhet vendor, mbështetje donatorësh | Numër dhe larmi aktivitete; përfshirje gjithëpërfshirëse |
| 1. Vizita në bibliotekë (për Ditën e Gjuhës Amtare dhe Ditën e Librit) | Shkurt & Prill | Drejtorja e Arsimit dhe Institucionet Arsimore | Biblioteka, Bashkia, Drejtorja Rajonale e Kulturës | Buxhet shkollor, mbështetje nga institucionet kulturore | Numri i vizitave në bibliotekë; pjesëmarrja e fëmijëve |
| 2. Ekskursione edukative në muze, galeri, qendra sportive dhe aktivitete komunitare. | Çdo vit | Drejtorja e Arsimit dhe Institucionet Arsimore | Prindër, OJQ | Buxhet vendor, mbështetje donatorësh | Numër dhe larmi aktivitete; përfshirje gjithëpërfshirëse |
| 3. Fushata: “Leximi na Bashkon” (me bashkëpunimin e institucioneve kulturore) | Prill | Drejtorja e Arsimit dhe Institucionet Arsimore | Qendra Kulturore, Biblioteka, Prindër | Mbështetje donatorësh, Buxhet vendor | Nxitja e kulturës së leximit të nxënësve, Numri i librave të dhuruar; numri i fëmijëve të përfshirë, Takime me autorë dhe shkrimtarë lokalë. |
| 4.Fushata:Art pa kufij Fushatë kulturore në shkollat që synon shkëmbimin artistik mes nxënësve të Bashkisë Fier dhe shkollave të tjera europiane përmes artit, kulturës dhe krijimtarisë. | | Drejtorja e Arsimit dhe Institucionet Arsimore | Shkollat partnere në BE, OJF kulturore ndërkombëtare | buxhet vendor + donatorë | Nr. shkollave pjesëmarrëse; nr. nxënësve të përfshirë; nr. aktiviteteve |

| | | | | | |
|---|-------------|--|--|---|---|
| <p>5. “Pedalo për turizëm dhe kulturë” – aktivitet në hapësira publike me mbështetjen e institucioneve vendore</p> <ul style="list-style-type: none"> ✚ Pedalim me biçikleta në pedonalen e qytetit ✚ Ekspozitë me punime, vizatime dhe postera | Maj–Qershor | Drejtoria e Arsimit dhe Institucionet Arsimore | Bashkia, Drejtoria e Kulturës, Policia Bashkiake | Bashkia, partnerë lokalë | Numri i fëmijëve pjesëmarrës; numri i punimeve ekspozuar |
| <p>6. “Pedalo Kuq” – marshim festiv me bashkëpunim ndërsektorial për Festat Kombëtare</p> | Nëntor | Drejtoria e Arsimit dhe Institucionet Arsimore | Bashkia, Drejtoria e Arsimit, Policia Bashkiake, MA | Buxhet vendor, sponsorizime private | Numri i pjesëmarrësve; vlerësim nga prindërit dhe publiku |
| <p>7. F u s h a t a “Shkolla e Gjelbër” Transformimi i shkollave në mjedis ekologjike dhe të qëndrueshme.</p> | | Drejtoria e Arsimit dhe Institucionet Arsimore | Drejtoria e Gjelbërimit, OJF mjedisore, shkollat | Buxhet vendor, sponsorizime private donatorë + projekte mjedisore | Gjelbërim i oborreve shkollore. Nr. aktiviteteve mjedisore; sasia e mbetjeve të ricikluara; nr. pemëve të mbjella |
| <p>8. “Javët e riciklimit” në shkolla dhe kopshte Partnerë - Grumbullim mbetjesh, ekspozita me punime nga materiale të riciklueshme.</p> | | Drejtoria e Arsimit dhe Institucionet Arsimore | Shoqata mjedisore, Ndërmarrja e Pastrimit, NVM të riciklimit | Buxhet vendor, sponsorizime private | Numri i pjesëmarrësve; vlerësim nga prindërit dhe publiku |
| <p>9. “Ekskursion ekologjik” në zona natyrore të Fierit- Mësim në natyrë, vëzhgim dhe edukim mbi biodiversitetin.</p> | | Drejtoria e Arsimit dhe Institucionet Arsimore | Agjencitë e menaxhimit të zonave të mbrojtura, shkollat | Buxhet vendor, sponsorizime private | Numri i pjesëmarrësve; vlerësim nga prindërit dhe publiku |

| | | | | |
|--|---|--|---|--|
| <p>10. “Uji është jetë” -Projekt edukativ ndërshkollor për ndërgjegjësimin e nxënësve mbi rëndësinë e ujit dhe ruajtjen e tij. Përfshin aktivitete praktike si panele informuese, ekspozita me posterë, eksperimente shkencore në klasë dhe vizita në impiante të ujësjellësit dhe trajtimit të ujit.</p> | <p>Arsimit dhe Institucionet Arsimore</p> | <p>Ujësjellësi Fier, ISHP, ZVA</p> | <p>Buxhet vendor, sponsorizime private</p> | <p>Nr. shkollave pjesëmarrëse; nr. nxënësve të përfshirë; nr. aktiviteteve të realizuara; nivel ndërgjegjësimi mbi kursimin e ujit</p> |
| <p>11. Dita Ndërkombëtare e Romëve 8 Prill Organizim aktiviteteve ndërgjegjësuëse dhe kulturore në institucionet arsimore të Bashkisë Fier për promovimin e përfshirjes sociale, barazisë dhe kulturës romë. Aktivitetet përfshijnë prezantime kulturore, punime artistike, histori, muzikë dhe diskutime edukative mbi diversitetin dhe gjithëpërfshirjen.</p> | <p>Arsimit dhe Institucionet Arsimore</p> | <p>Shkollat dhe kopshtet, OJF rome, Zyra e Përfshirjes Sociale, Bashkia Fier</p> | <p>Buxhet vendor + donatorë + organizata ndërkombëtare (UNICEF, OSBE)</p> | <p>Nr. aktiviteteve të realizuara; nr. fëmijëve pjesëmarrës (përfshirë komunitetin rom dhe egjiptian); nivel i përfshirjes sociale</p> |
| <p>12.Fushata: “Shkolla në Lëvizje” Nxitja e aktivitetit fizik dhe stilit të shëndetshëm të jetesës në shkolla ,lojëra sportive ndërklasore, aktivitete në natyrë</p> | <p>Drejtorja e Arsimit dhe Institucionet Arsimore Drejtorja e Sportit</p> | | <p>Buxhet vendor, sponsorizime private</p> | <p>Nr. nxënësve pjesëmarrës, nr. aktiviteteve sportive</p> |
| <p>13. Fushata: “Shkolla pa Braktisje” identifikim të hershëm të rasteve në rrezik, ndërhyrjes sociale, mbështetjes psiko-sociale dhe përfshirjes së familjeve në procesin arsimor.</p> | <p>Drejtorja e Arsimit dhe Institucionet Arsimore</p> | <p>Shërbimi Social, shkollat Prindër, OJF</p> | <p>Buxhet vendor + donacione</p> | <p>Ulja e braktisjes shkollore (%).Nr. fëmijëve të rikthyer në shkollë; nr. rasteve të mbështetura</p> |

• Monitorimi dhe vlerësimi

Zbatimi efektiv i Planit të Arsimit Parauniversitar kërkon një sistem të qartë dhe të qëndrueshëm monitorimi dhe vlerësimi, që siguron ndjekjen sistematike të progresit dhe ofron bazën për përmirësime të vazhdueshme. Ky sistem është i lidhur ngushtë me objektivat dhe aktivitetet e planit të veprimit dhe mbështetet në të dhëna të verifikueshme, pjesëmarrje të aktorëve dhe transparencë institucionale.

Indikatorët e Performancës

Indikatorët e performancës janë të përqendruar në vlerësimin e rezultateve të arritura në raport me objektivat strategjike. Ata janë të ndërlidhur me çdo kategori aktivitetesh në planin e veprimit dhe do të përdoren për matjen e progresit të përvitshëm. Këta përfshijnë:

- ❖ Numrin e institucioneve të rikonstruara ose me kushte të përmirësuara;
- ❖ Numrin i kopshteve (hapësirave) të reja funksionale;
- ❖ Rritjen e regjistrimeve në kopshte dhe përfshirjen e fëmijëve nga grupe në nevojë;
- ❖ Numrin e mësuesve dhe edukatorëve të trajnuar;
- ❖ Cilësinë e mësimdhënies dhe përdorimin e mjeteve didaktike dhe teknologjisë;
- ❖ Numrin e aktiviteteve jashtëmësimore dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në to;
- ❖ Mbështetjen sociale për fëmijët në nevojë (ushqim, mjete, shërbime psiko-sociale);
- ❖ Efiçienca në furnizim, mirëmbajtje dhe shërbime mbështetëse.

Planifikimi i vlerësimit të progresit

Progresi i planit do të vlerësohet përmes mekanizmave të strukturuar të raportimit dhe analizës, të cilët do të jenë të integruar në ciklin e planifikimit buxhetor dhe vendimmarrjes vendore. Vlerësimi do të përfshijë:

- ❖ Raportime vjetore mbi realizimin e aktiviteteve të planifikuara;
- ❖ Matjen e ndikimit të investimeve në infrastrukturë dhe cilësi shërbimi;
- ❖ Analizën e të dhënave të mbledhura përmes monitorimit në terren;
- ❖ Vlerësimin e përmirësimit të qasjes, përfshirjes dhe mjedisit të të nxënit;
- ❖ Ndërlidhjen e progresit me planifikimin e ardhshëm afatmesëm.

Përfshirja e aktorëve të jashtëm

Për të garantuar objektivitetin, transparencën dhe përmirësimin e vazhdueshëm, do të sigurohet përfshirja aktive e aktorëve të jashtëm, si:

- ❖ Ekspertë të pavarur në fushën e arsimit, të ftuar për të kryer vlerësime tematike;
- ❖ Organizata joqeveritare që merren me cilësinë e arsimit dhe përfshirjen sociale;
- ❖ Këshillat e prindërve, drejtuesit e shkollave dhe komunitetet vendore;
- ❖ Njësitë e statistikës/performancës dhe monitorimit të bashkisë për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave;
- ❖ Partnerë ndërkombëtarë në kuadër të projekteve të mbështetura financiarisht.

Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimi

Monitorimi i planit do të realizohet në dy drejtime kryesore:

- **Monitorimi i nivelit të realizimit të aktiviteteve të planifikuara**
- **Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve në komunitetin arsimor**

Monitorimi i realizimit të aktiviteteve

Çdo aktivitet i planit do të vlerësohet në bazë të një sistemi pikëzimi nga 0 deri në 10, ku:

0 – Aktiviteti nuk ka nisur.

1–9 – Aktiviteti është pjesërisht i realizuar, në varësi të nivelit të zbatimit.

10 – Aktiviteti është realizuar plotësisht sipas planifikimit.

Për secilin objektiv strategjik të planit, do të përcaktohet numri total i pikëve maksimale, duke shumëzuar numrin e aktiviteteve të planifikuara për objektivin përkatës me 10 (p.sh., 5 aktivitete x 10 = 50 pikë maksimale për objektivin).

Gjatë zbatimit, pikët reale të arritura për çdo aktivitet do të regjistrohen, dhe më pas do të përmbledhen në nivel objektiv. Kjo do të mundësojë llogaritjen e përqindjes së realizimit të secilit objektiv në kohë reale.

Përqindja e realizimit të objektivit = (Pikë të realizuara / Pikët maksimale) × 100

Ky mekanizëm do të sigurojë një vlerësim të qartë, të matshëm dhe të krahasueshëm për zbatimin e planit përgjatë viteve.

Vlerësimi i ndikimit në komunitet

Për të matur ndikimin e aktiviteteve në komunitet, do të monitorohet shkalla e pjesëmarrjes së institucioneve arsimore dhe fëmijëve në zbatimin e tyre.

Për çdo aktivitet do të vendosen targete të matshme:

- Numri i kopshteve dhe shkollave të synuara.
- Numri i fëmijëve të parashikuar për përfshirje (në kopsht dhe shkollë, sipas rastit).

Në përfundim të zbatimit të çdo aktiviteti, do të regjistrohet:

- Numri real i institucioneve që morën pjesë (në kopsht ose shkollë).
- Numri real i fëmijëve të përfshirë.

Për çdo aktivitet do të llogaritet përqindja e pjesëmarrjes së arritur sipas formulës:

Përqindja e pjesëmarrjes = (Numri real i pjesëmarrësve / Numri target) × 100

Ky tregues do të ndihmojë në vlerësimin e shkallës së përfshirjes dhe impaktit që ka pasur secili aktivitet në komunitetin arsimor.

- **Rishikimi dhe përshtatja e planit**

Rishikimi dhe përshtatja e planit janë mekanizma thelbësorë për të siguruar vazhdimësinë, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve të planifikuara në fushën e arsimit parauniversitar në Bashkinë Fier. Këto proçese shërbejnë për të ruajtur koherencën midis objektivave të planit, nevojave reale në terren dhe zhvillimeve të reja institucionale, ligjore apo sociale.

Procesi i rishikimit

Rishikimi i planit do të bëhet në mënyrë të strukturuar dhe të paracaktuar, me qëllim që të vlerësohet në mënyrë periodike efektiviteti i masave dhe aktiviteteve të ndërmarra. Planifikohen këto forma rishikimi:

Rishikimi vjetor – i fokusuar në përditësimin e planit të veprimit dhe buxhetit vjetor në funksion të rezultateve dhe ndryshimeve të kontekstit;

Rishikimi afatmesëm (në fund të vitit 2028) – për të analizuar realizimin e objektivave strategjike, performancën e indikatorëve dhe për të orientuar masat për vitin 2029;

Rishikime të jashtëzakonshme, në rast të ndryshimeve madhore (si reformë e kuadrit ligjor, emergjenca, ndryshime buxhetore të rëndësishme).

Ky proces do të kryhet në mënyrë ndërsektoriale, me pjesëmarrjen e drejtorive përgjegjëse, përfaqësuesve të institucioneve arsimore dhe aktorëve të tjerë vendorë.

Përshtatja e masave dhe aktiviteteve

Bazuar në të dhënat që rezultojnë nga monitorimi dhe vlerësimi i planit, si dhe në konsultimet me komunitetin arsimor, do të ndërmerren përshtatje të nevojshme në:

Aktivite konkrete – duke përmirësuar përmbajtjen, kohëzgjatjen, mënyrën e zbatimit apo përgjegjësit;

Alokimin e burimeve – në rast se disa fusha kërkojnë më shumë mbështetje për të arritur objektivat;

Prioritetet vjetore – në përputhje me nevojat emergjente të fëmijëve, stafit arsimor apo komunitetit lokal;

Metodologjinë e zbatimit – duke integruar praktikat më të mira dhe rekomandimet e vlerësimeve të jashtme.

Ky fleksibilitet në përshtatje synon të sigurojë që plani të mos mbetet një dokument statik, por të jetë një instrument dinamik, funksional dhe i orientuar drejt rezultateve reale për përmirësimin e arsimit parauniversitar në Bashkinë Fier.

- **Raportimi dhe transparenca**

Zbatimi i Planit të Arsimit Parauniversitar do të shoqërohet me mekanizma të qartë raportimi dhe transparence, për të garantuar përgjegjshmëri institucionale dhe përfshirje qytetare në vlerësimin e progresit.

- **Raportimi i progresit** do të realizohet përmes raporteve periodike vjetore, të cilat do të përfshijnë ecurinë e zbatimit të objektivave, sfidat e hasura dhe masat korigjuese të ndërmarra nga njësitë përkatëse.
- **Përfshirja e publikut** do të sigurohet përmes publikimit të raporteve dhe rezultateve në faqen zyrtare të bashkisë, organizimit të takimeve konsultative me komunitetin dhe mundësimin të pjesëmarrjes qytetare në propozimin dhe vlerësimin e masave për përmirësimin e sistemit arsimor.

- **Aneks 1: Kuadri Ligjor dhe nënligjor për Arsimin Parauniversitar**

Kuadri Kushtetues dhe Ligjor i përgjithshëm

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 57, pika 1
- Ligji Nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2018
- Ligji Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- Ligji Nr. 9936/2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji Nr. 68/2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- Ligji Nr. 9632/2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar

Arsimi Parashkollor dhe i detyrueshëm (Bazë)

- Urdhër nr. 31, datë 28.01.2020, “Për miratimin e Rregullores për Funkcionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare”
- Udhëzim Nr. 14, datë 10.7.2023, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore në arsimin parauniversitar”
- Udhëzim i përbashkët MAS–MEKI nr. 20, datë 13.08.2025, “Për vitin shkollor 2025– 2026 në sistemin arsimor parauniversitar”
- Udhëzim Nr. 25, datë 25.07.2018, “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”
- Urdhër nr. 199, datë 07.05.2024, “Për miratimin e Kornizës së vlerësimit të cilësisë së kopshtit”

Përfshirja dhe mbrojtja e fëmijëve

- Ligji Nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji Nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
- Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021–2025
- Udhëzim Nr. 21, datë 08.08.2014, “Për rritjen e frekuentimit të arsimit parashkollor nga fëmijët romë”
- Udhëzim i përbashkët MAS–MShMS nr. 658, datë 23.09.2019, “Për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme në internet”

Shërbimi psiko-Social dhe Përfshirja Sociale

- Urdhër nr. 313, datë 20.10.2020, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psiko- social në institucionet e arsimit parauniversitar”
- Udhëzuesi për Praktikën e Punës së Shërbimit Psiko-Social Shkollor, për punonjësit e ZVA-ve dhe strukturat arsimore vendo

SHKOLLA ARTISTIKE "JAKOV XOXA"

